

## HISTORIA E TË ARDHMES



Veselin Vukotiq, rektor

## ALMANAK I MËSIMIT

-idetë për miratim përmes shqyrtimit dhe përvijës personale-

SI NGA STUDIMET E TASHME PËR TË MËSUARIT E NOTIMIT NË BASEN DERI TE STUDIMET PËR TË  
MËSUAR NOTIN NË LUMIN MALOR

**11.11.2013**



---

***“ E di që nuk di !”***

**( Sokrati)**

***“Imagjinata është më e rëndësishme se dija!”***

**( A. Ajnshtajn)**

***“Në ekonominë globale mes veti të lidhur, e cila bazohet mbi informacione, universitetet, ndërmarrjet dhe individët gjithnjë e më tepër garojnë me më të mirët në botë.***

***Gjithnjë e më shtrenjtë është të jesh më i dobët se klasa e vërtet botërore, njëjtë siç është gjithnjë e më e çmuar të jesh vërtet i madh”.***

**( Xh. Kollvin)**

## PSE DHE KUJT ALMANAKU?

Këtë material do ta fitojë çdo bashkëpunëtor dhe mësues në UDG që ka kontratë për mësim ose hulumtime në UDG. Po ashtu, do ta fitojë edhe secili student i interesuar i UDG dhe prindërit e tyre . Materiali është i mundshëm vetëm si hard copy ( në versionin e shtypur) dhe në një farë mënyre paraqet sekretin tonë të afarizmit ( në këtë fazë- fazën e shqyrtimit). Karakteri i sekretit afarist i obligon shfrytëzuesit në përdorim adekuat të këtij materiali.

Idetë nga materiali do të jenë temë debati dhe shqyrtimi në tryezat e rrumbullakëta , të cilat tradicionalisht i organizojmë dhe jemi Universiteti i vetëm në rajon me praktikën e tillë. Të drejtë prezantimi në debatet e organizuara në tryezat e rrumbullakëta, kanë vetëm studentët , bashkëpunëtorët dhe mësuesit në UDG. Tryezat e rrumbullakëta do të organizohen me të njëjtat rregulla sikur të mëparshmet , kushtuar çështjeve të mësimit në kuadër të ciklit **Filozofia dhe praktika e vizionit të UDG** në kontekstin **UDG në EU** . Temat nga tryezat e rrumbullakëta, e në secilën ishin të pranishëm së paku 250- 300 student , bashkëpunëtor dhe profesor , ishin:

- Drejtimet dominuese të modernizimit dhe zhvillimit;
- Esenca e të menduarit – fije lidhëse ideore për njohuri profesionale;
- Shkathtësitë ( aftësi universale e studentit);
- Plani mësimorë ( tërësia dhe arkitektura dinamike e disiplinave të veçanta);
- Metodot e mësimit.

Materiali ka për qëllim që edhe për të menduarit dhe për praktikën të kalohet nga modeli klasik i mësimit  $S = P + V$ , në modelin  $S = z \cdot i^2$  ( “Ekuacioni i profesorit ), që është shprehje model në qasjen inovative të të mësuarit në UDG. Qëllimi i këtij modeli është të tregoj formën, metodologjinë dhe mënyrën e organizimit të mësimit dhe hulumtimeve në UDG , i cili si “prodhim” final ka studentin i cili është **ekspert në pasiguri** - i aftë të ketë guximin në sjelljen e vendimeve në bazë të numrit (vëllimit) të pa mjaftueshëm të informacioneve: personit që shikon me mend: personi që sheh në errësirë . Në botën komplekse ( të përbërë) në të cilën realiteti ndryshon aq shpejtë, është e pamundur grumbullimi i 100% të informacioneve dhe hyrja në zonën e sigurisë . Ideja ime bazohet në përvojën time personale disa decenie, si dhe në suksesin dhe identifikimin e studentëve të mi në praktikë, në hulumtimin e përhershëm të procesit të mësimit si dhe respektimin e principit të “destrukcionit kretativ” ( J.Shumpeter) dhe “relacionit të papërcaktueshmërisë” (V.Hajzenberg), por edhe të “evolucionit kreativ” (H.Bergson). E gjithë kjo shkon drejtë thënies së Njegoshit “ Çfarë do që të vijë, asaj i jam gati”, mendim i cili në mënyrën më të plotë shpreh botëkuptimin tim të ekspertit në pasiguri dhe është njëri nga shtyllat kryesore të platformës sime emotive dhe të menduarit.

Studimet duhet të ndihmojnë studentin ta kuptojë se jeta është dhuratë nga Zoti!

Në ç' mënyrë procesi i arsimit të transferohet nga përgatitjet e studentëve për "notim në basenin e hotelit" në aftësi për notimin e tij në pasiguri dhe të dridhurat, gjësimin dhe shpejtësinë e lumit të bjeshkës? Në ç' mënyrë nga të mësuarit artificial, të kalohet në atë natyror, si nga idealizmi i Platonit, në tundimet e jetës? Në ç' mënyrë nga të mësuarit për botën (jetën) në të mësuarit nga bota (jeta)?

Kjo është korniza mentale nga debatet tona në Tryezat e rrumbullakëta, por edhe për të menduar për secilin bashkëpunëtor dhe mësues të cilët dëshirojnë dhe që karrierën e vet e shohin në UDG. Aq më tepër, për ata të cilët dëshirojnë që **shpirti i tyre** në mësues dhe edukimin e studentit, **ta mbijetojë** kënaqësinë e tij momentale me të arriturat e kriterëve formale dhe burokratike, të cilat kërkohen për zgjedhjen e mësuesve dhe bashkëpunëtorëve .

Mos harroni se studentët tonë të tanishëm, së shpejti do të jenë prindër. Andaj, investimin në studentë duhet kuptuar edhe si investim në fëmijët e tyre – në karakterin e fëmijëve të tyre, në mënyrën e të menduarit, edukimin, kulturën... Hyrja jonë në studimore, të mos harrojmë, është investim në identitetin tonë, investim për të kujtuar të parët tonë dhe respekt ndaj gjithë asaj që kemi trashëguar nga ata, por edhe investim në kujtesën e gjeneratave të ardhshme! Gjeneratat kujtojnë vetëm krijuesit !... Për këtë arsye, ky Almanak, apriori i është kthyer **Zotit të krijimtarisë**, respektivisht studentit, bashkëpunëtorit dhe profesorit në UDG dhe të gjithë atyre që janë të vetëdijshëm dhe respektojnë sfidat e veta krijuese, si dhe misionin krijues të UDG.

## PRINCIPET E ALMANAKUT NË MËSIMDHËNIE DHE HULUMTIME NË UDG

Të nderuar kolegë dhe kolege, studentë, bashkëpunëtorë dhe profesor në UDG; të nderuar miq të UDG.

Në bazë të disa orëve dhe bisedave të zhvilluara me studentët e gjeneratës të sapo regjistruar (2013/14) si dhe në bazë të përvojës së deritashme, dëshiroj të ju tërheq vërejtjen në disa premisa dhe principe pedagogjike, të cilat duhet respektuar në procesin e mësimin në UDG dhe të cilat duhet të sjellin deri tek vendosja e Almanakut në mësim dhe hulumtime në UDG.

Almanak është kuptuar si agjendë mentale nga të gjithë ata që janë të kyçur në mësimdhënie në UDG.

Almanak është ndërtuar në bazë të platformës së të kuptuarit se UDG është **universitet privat**, pronar të të cilit, në esencë, janë studentët, bashkëpunëtorët dhe mësimdhënësit, të cilët **zhvillimin e vet personal dhe profesional**, e shohin në UDG dhe nga UDG.

Përvoja jetësore e cila rrjedh nga rëniet dhe të arriturat personale, gati më ka ankoruar në platformën emocionuese dhe të menduarit, dhe e cila **në katër këndvështrimet** e veta bazohet në dy mendimet e dijetarit më të madh në historinë e njerëzimit, Albert Ajnshtajn : a) "Imagjinata është më e rëndësishme se sa njohuritë"; b) "Është marrëzi të presësh që duke vepruar në mënyrë të vjetër do të arrish rezultate të ndryshme; Këndvështrimi i Kliping-ut - "Do të jesh njeri, biri im"; d) Nga këndi i Njegoshit; " Çfarëdo që të vijë, asaj i jam gati". Në qendër të platformës, në zemrën e sajë është bërë gravurë fjala, në esencën e të cilës janë **kreativiteti kaotik dhe liria e të krijuarit**. Platformën, kaherë e lëviz miti i **shpirtit të shenjtë**, i cili në kohën e sotme quhet **shpirti global i racës njerëzore**, shpirti i para ardhësit tonë i cili para 200.000 vjetësh është nisur nga liqeni i Rudolfit ( Etiopia e sotme ) duke mos ditur apriori si dhe ku do të mbërrijë... Dhe ka arritur deri... më sot!

Dhe pikërisht ideja dhe konteksti i Almanakut, qëndrojnë mbi këtë platformë emocionuese dhe të menduarit, e cila duke lundruar gjithnjë, gjurmon në oqeanin e diturisë time dhe tuajën. Almanak është sistemi themelor i vlerave të mësimin në UDG, nga i cili dhe në bazë të të cilit, definohen normat e sjelljes të të gjithë pjesëmarrësve në procesin mësimor dhe hulumtues. Almanakun, e shohim si gejzer të ideve të cilat lindin gjithnjë, gejzer i cili formon energji të reja dhe të frytshme kreative, intelektuale dhe atmosferë akademike në UDG, atmosferë që ka të bëjë me zhvillimin e aftësive, mënyrën e të menduarit dhe kulturën e sjelljes të studentëve, të rëndësishme si **barku i nënës** për foshnjën e pa lindur. Thënë në mënyrë metaforike, qëllimi i Almanak, është largimi nga thithja pasive si shpuzë e të vjetrës, e asaj që veç është parë. Respektivisht si të rigjenerohet procesi i mësimin në UDG... **Si ta kuptojmë të gjithë se aftësia njerëzore, e jo kapitali në para, sot është resursi kryesor i zhvillimit! Në ç mënyrë UDG të krijojë njerëz të aftë – kjo është ideja kryesore në esencën e këtij Almanaku.**

Almanak përfshinë, mes tjerash, këto premisa dhe principe, të paraqitura pa ndonjë sistemim të rëndomtë:

1. Është e nevojshme të lexohet libri “Gjenerata UNË “ ( Xhin M.Tvenxh), botuar nga biblioteka “Oeconomicus”, CID, që të arrihen përshtypjet themelore për vetitë e karakterit dhe sistemin e vlerave të të rinjve , studentëve tonë. Lënia pas dore e hendekut mes gjeneratave mund të ndikoj në kualitetin përfundimtar të studentit tonë.

2 . Librin “Të rritesh digjital”, nga autori Don Tapskot, i cili tregon në karakteristika të ngjashme të gjeneratës së sotme, respektivisht trajton çështjen “si gjenerata e rrjetit e ndryshon botën tuaj”.

3. Që studentët, në veçanti bashkëpunëtorët dhe profesorët vërtet të kuptojnë se asgjë nuk është e përjetshme, madje as ky civilizimi i sotëm , dhe se studentët tonë, jam i sigurt, do të përjetojnë ashpërsinë e **tranzicionit të civilizimit**, është e nevojshme që, mes tjerash, të njihen me idetë e Osvalld Shpengler ( “ Shkatërrimi i perëndimit”), Henri Bergson ( “ Evolucioni krijues ”), Tomas Kun ( “ Struktura e revolucioneve shkencore”), Jose Gaseta ( Revolta e masave ”), Xhon Horgman ( “Fundi i shkencës” ) dhe Roxher Penrase ( “Mendja e re e perandorit”).

4. Koha e pasigurisë- mosha e studentëve tonë dhe pasardhës ve të tyre, do të kërkojnë plot imagjinatë, ide të reja, kreativitet... Me të drejtë Volteri, njëri ndër dijetarët kyç, kishte thënë se libri i vetëm i obligueshëm të cilin nxënësi duhet ta lexojë është “Robinson Kruso”, nga Danijel Defo. Unë, sot kisha shtuar edhe përrallat nga Anderseni , si dhe Zhill Vern dhe Aldous Haksli.

5. Të mësuarit nga jeta do të thotë të mësuarit nga përvoja personale, por edhe të mësuarit nga historia. Historia i jep kontekstin ( orientimin ) përvojës sonë, zgjeron shikimin drejt të ardhmes. Krijimtaria monumentale e H.XH. Vells , D. Borstin, V. Djurante, mitologut Xhozef Kembell, na ndihmon të kuptojmë si dhe pse kanë menduar dhe janë sjell ashtu njerëzit e asaj kohe dhe se në atë , në mendimin dhe sjelljen e tyre, gjejmë rrënjët e të menduarit të sotëm.

6. Letërsia, poezia, arti... Si këtë formë të përvojës personale krijuese të autorëve dhe artistëve, ta shfrytëzojmë si nxitje personale shpirtërore? Përse, fotografitë e para të kafshëve nëpër muret e shpellave në të cilat kanë jetuar të parët tonë, ishin hapat e parë në zhvillimin shpirtëror dhe të menduarit , e kanë dalluar të parin tonë nga mbretëria e kafshëve?

Epoka e rëndësisë së letërsisë, poezisë dhe artit, në zhvillimin shpirtëror të njeriut të sotëm veç është duke ardhur... UDG është historia e të ardhmes.

7. Puna me studentët, e jo vetëm me ata, nënkupton që mësuesit dhe bashkëpunëtorët, kanë të zhvilluar aftësitë e vlerësimit të njerëzve dhe situatave. Njohja e psikologjisë së individit dhe mentalitetit të njerëzve, është parakusht i komunikimit të mirëfilltë dhe mirëkuptimit të ndërsjellë. Për këtë arsye , mes tjerash, duhet lexuar librin nga Jovan Cvijiq, “Uniteti dhe tipat psikologjik të sllavëve dinarik të jugut”, pastaj nga Todor Bakoviq “ Optimizmi depresiv i

malazezëve”, nga Millovan Gjillas “Vendi i pa gjyqë”, Veselin Vukotiq “Filozofia e biznesit”....Rekomandohet edhe “Njohja e njeriut”, nga Adler, pastaj nga Jung, Frojdi dhe Fjodor Dostojevski... Nuk mund të zhvillohet asgjë në origjinal, e kjo do të thotë edhe kreative, nëse nuk njihet psikika e vet dhe psikika e njerëzve me të cilët punon ! Për këtë arsye duhet njohur më tepër historinë e vet nacionale – **Historinë e Malit të Zi dhe historinë e Ballkanit.**

8. Bazën jetësore –moralo- emotive të studimeve në UDG , në veçanti e shprehin poezia “ Do të jesh njeri, biri im” nga Kliping; “Momentet ,” nga Borhes, pastaj poezia “ Të mendosh”, nga Wintle si dhe vepra e Njegoshit “ Nata më e shtrenjtë se jeta”.

9. Ndryshimi i metodave në realizimin e çdo disipline në mësimdhënie është e kushtëzuar, jo vetëm me ndryshimet e shpejta teknologjike dhe ndryshimet në kërkim të diturive , por edhe me **ndërrimin e gjeneratave.** Andaj është e nevojshme që secili bashkëpunëtor dhe mësimdhënës të ketë parasysh këto fakte dhe aq sa të jetë e mundur , ti zbatoj ato ndryshime në procesin e mësimin dhe në punë me studentët.

10. Përse truri i gjeneratës së sotme është ndryshe? A jemi të vetëdijshëm për këto dallime? Në ç’ mënyrë këto dallime ti kultivojmë në botëkuptimin tonë dhe në zbatimin e mësimin? Përse është i dëmshëm qëndrimi i të vjetërve : “Ne ishim më të mirë”? ( Lidhur me këtë do të organizohen seminare me ekspert të llojit të ri, “ të shkencës së brendshme”, neuroshkencës, shkencës e cila zhvillon “ qasje emotive ndër disiplinare të themeluar për hulumtimin e trurit” . Për vetë arsimim personal , shih p.sh. librin nga Erik Jensen , “ Të mësuarit me tru në mendje”)

11. Përvoja në UDG, na vërteton suksesin e konceptonit të ri të studimeve, inovacionet tona të bazuara në modelin  $S = z * i$  . Modeli tenton përgjigjen në pyetjen se në ç’ mënyrë dija e studentëve mund të shndërrohet ( konvertohet) në aftësi të tij. Si pikënisje kemi supozimet jetësore se **dija** vetë vetiu **nuk do të thotë aftësi.**

Qëllimi ynë duhet të jetë aftësia e studentit, studenti i aftë, krijues ( S ) me dituri moderne ( z ) e cila përmes përvojës, punës dhe jetës në fakultet ( i ), përmes zhvillimit të karakterit dhe kompetencave të studentit , ta shndërroj ( konvertoj ) në **aftësi të studentit**, në forcë të tij krijuese - “  $i^2$ ” në këtë ekuacion duhet kuptuar në **kërkim** të përhershëm dhe të vendosur të përvojës personale. Secili ligjërues dhe bashkëpunëtor do të duhej të jenë në kërkim të modelit dhe metodës për lëndën e vet, e cila në esencë i përgjigjet  $S = z * i^2$  . Konceptoni i tanishëm në shumicën e lëndëve mësimore është  $S = z + i$  ( studimet = ligjëratat + ushtrimet) dhe ai është më tepër i karakterit mekanik, të karakterit jo gjithëpërfshirës ; arritja e diturisë parçiale e jo asaj të rrjetëzuar ....Ndërkaq, modeli  $S = P + V$  është dispozitë ligjore , që dëshmon nevojën e reformës së thelluar në arsimin e lartë, jo vetëm në Mal të Zi.

Si të gdhendet dija në imagjinatën e çdo studenti? Ushtrimet e ndryshme praktike , esetë, debatet e ndryshme, oratoria dhe mbi të gjitha hulumtimet ( shembuj praktikë për provime) si dhe prezantimet e që janë vetëm disa nga format e mundshme në **“ kultivimin e dijes në aftësi të studentit”**.

12. Ç do ligjërues dhe bashkëpunëtor , në fund të orës apo çfarëdo aktiviteti tjetër mësimor, duhet të pyes veten : “ Sa e kam lëvizur ( nxitur ) sot studentin ?... Sa, ora apo ndonjë tjetër aktivitet, i kontribuon zhvillimit të aftësive kreative apo afariste të studentit , emancipimit të tij kulturor ; sa i kam kontribuar vizionit për veten e tij në të ardhmen , sa i kam lëvizur ( nxitur) emocionet e tij, ose ia kam tunduar disa nga paragjykimet , sa e kam motivuar që në mënyrë të pavarur të gjurmoj përvojën e vet.

Secili mësimdhënës dhe bashkëpunëtor duhet ta ketë si shprehje se fjala “ të mësosh”, “ i mësuar” , “të mësuarit për mendësh” nuk ka vlerën e përdorimit , nëse nuk është në kontekstin e “ **evolucionit krijues të studentit** ” ( H.Bergson). Depoja e materialit ndërtimor është e rëndësishme për ndërtimin e shtëpisë , por ende nuk është shtëpi – shtëpia në mënyrë metaforike është kuptuar si kreacion i dijes dhe aftësisë afariste të ndërtuesit ( krijuesit). Të mos përgatisim studentë që do të jenë “depo” të cilët do ti blejnë mirëbërësit për ti punësuar....Kuptohet, parakushti për qasje të këtillë të re të mësimi është arsimtari, respektivisht bashkëpunëtori jo vetëm që din por edhe e kupton atë që u ligjëron studentëve.

“Leksionet gojore” dhe “Sllajd ligjëratat” nuk e zgjojnë dhe nuk e lëvizin studentin dhe shpirtin e tij.

13. A thua secili bashkëpunëtorë dhe arsimtarë e pyet veten në fund të ditës –çfarë kam krijuar sot(jo punuar)? A thua sot e kam pasuruar (pllenuar)kopshtin e ideve të mija; a e kam nxitur sot studentin; a kam bërë sot një hap drejt njohjes së vetë vetes?...Vetëm qasja e këtillë mënyrës së të menduarit dhe jetës mund të jetë nxitës i ideve të reja, kreacionit...Duhet të lirohemi nga titullimet, emërimet(të cilat duhet ti kemi sepse jetojmë jo në natyrë, por në civilizimin burokratik)si dhe në egon personale, nëse dëshirojmë të zhvillojmë modelin e ri të arsimit, të jemi njëri ndër universitetet në Perëndim në të cilin zhvillohet embrioni i arsimit në të ardhmen.

14.Si ta përgatisim studentin tonë që të gjendet në shkatërrimin e pashmangshëm të civilizimit të tanishëm burokratik? Si ta kuptojnë studentët se kultura, e kuptuar si sistem i vlerave, mënyra e të menduarit, tradita, zakonet, me një fjalë shpirti jashtë kohës, **mbi kohën** ,dhe se civilizimi është mjetë tekniko-teknologjik për arritjen e qëllimeve praktike të njeriut të sotëm, se ai është i **përkohshëm**? Shpirti i një civilizimi gjithmonë mbijeton, kurse ana praktike e civilizimit është e vdekshme. Civilizimi romak është zhdukur kurse e shpirti i të drejtës romake ka vazhduar (Gj. Shushnjq).

15.**Identiteti** i Malit të Zi, respektivisht i të gjithë neve të cilët lindim dhe jetojmë në Mal të Zi tashmë varet, e në veçanti do të varet nga **kualiteti i arsimit**...Andaj është obligim atdhetarë që UDG të ofrojë dhe të zhvillojë kualitetin e studentëve të cilët do të jenë kompetentë në tregun global ( e ky treg veç është në Mal të Zi- prania e madhe, para së gjithëve, e investitorëve të huaj) dhe që studenti i UDG ta kuptojë se nuk është më i dobët nga më të mirët nga gjenerata e vetë nga universitet prestigjioze botërore .Arsimi në botë, në Perëndim veçanti, është në krizë të madhe të konceptionit. Kriza është shansi për secilin, e në veçanti për shkollat dhe universitetet e reja që të pozicionohen në tregun e gjerë me ide të reja dhe mënyrën e punës. Këtu e shohë shansin e UDG i cili edhe është themeluar mbi këtë vizion.

16.Rrënjësimi i UDG në **rrënjët intelektuale** të Malit të Zi, është i lidhur për **Llovqenin dhe Petrin e II Petroviq Njegosh**. Ora e parë është në Llovqen-para Njegoshit, nga gjenerata e parë e regjistruar. Fillimi i mësimi është me 04.korrik, çdo vit. Kjo është **Dita e lirisë** në UDG dhe dita kur studentin e UDG e përmbush krenaria e kujtesës në të parët dhe kur studenti zhvillon në Llovqen vizionin e ardhmërisë së vetë dhe gatishmërinë që të luftojë për të me kreativitetin dhe inovacionin e vetë në botën globale. Bota globale kërkon atë lokalen në traditë, historinë në të sotmen, në veçanti në të ardhmen.

17.Procesi ynë mësimorë duhet bazuar në maksimum se studentin nuk është konsumatori ynë, por ai është **prodhimi** i punës sonë. Nëse studentin trajtohet si konsumator, kurse “konsumatori është mbret” (Kotler), a guxon ta hidhëroni mbretin? Nëse mbreti nuk guxon të hidhërohet dhe nëse vjen koha, ligjërisht e obligueshme, e evoluimit të brendshëm të punës së arsimtarit dhe bashkëpunëtorit nga ana e studentëve , a ekziston rreziku që deri te notat e mira për studentë profesori të vijë me lëshime, të lejojë lëshime, duke mos respektuar kriteret dhe të ngjashme. **Në UDG nuk do të tolerohet**. Studenti



është prodhimi ynë me të cilin dalim në treg. Secili student ynë i papunësuar, student i pasuksesshëm është vlerësim i punës sonë njëjtë sikur secili student i suksesshëm. Vlerësimi nga studentët të cilët i dërgojmë në entin për punësim janë hipokrizi me të cilën kënaqen të pa përgjegjshmit dhe të pa aftët. Nëse studentit i afrohem sikur prodhimin (aftësia e tij/saj, kompetencat, karakteri ) atëherë puna jonë vlerësohet përmes tregut dhe karrierës të studentëve tonë. P.sh. ku ndodhen studentët dhe sa kanë arritur sukses afarist dhe në karrierë studentët tonë në moshën 35 vjeçare? Për të cilët studentë, suksesin e tyre, njihet UDG dhe disa nga fakultetet e UDG? Principi i këtillë do të thotë se nga koncepti i menduar, të profesorëve të sallorit kemi kaluar në profesorë-trajner, profesorë-motivues...Secili ligjërues dhe bashkëpunëtor le ta mendojë mirë këtë. Nuk është fjala për atë se a pajtoheni apo jo, por a e zbatoni këtë apo jo! Në mënyrë afatgjatë, Universiteti UDG duhet të ndajë fatin me studentët e vetë të diplomuar, suksesin apo mos suksesin e tyre. UDG jeton nga tregu, jo nga subvencionet shtetërore.

18. Detyrë jona parësore është të investojmë në **mënyrën e të menduarit të studentit**, respektivisht në **aftësinë e studentit** ! Si ti lirojmë nga kufizimi i fatit? “Përvojën e kemi nga përkufizimi i fatit”(Radomir Konstatinoviç). Në ç’ mënyrë ti lirojmë nga tortura e mediave? Në ç’ mënyrë ti lirojmë nga joshjet jo civilizuese të interesave partiake. Si ti lirojmë nga dija e mbyllur? Si të ua hapim mendjen? Në ç’ mënyrë të u hapim vizionet? Si të u zhvillojmë qasjen kritike ndaj jetës? Në ç’ mënyrë të zhvillojmë tek ata ndjenjën e të ardhmes. Si ti lirojmë nga kompleksi i mjedisit të vogël? Si të u kultivojmë besimin se edhe ata mund të jenë të suksesshëm në tregun global? Pse arrijnë sportistët tonë, por jo edhe ekspertët tonë-studentët e diplomuar? Si ti lirojmë nga frika e tentativës dhe gabimit? Si ti lirojmë nga egoja e tepruar dhe ndjenja e madhësisë lokale? Si ti lirojmë nga bindja se pa punë, dituri dhe kreativitet mund të përparohet?...

Dhe shumë të tjera...

Kjo është detyra jonë në studime. Apriori duhet që si ligjërues dhe bashkëpunëtorë të shikohemi në sy dhe të pyetemi: A i kemi përgjigjur edhe vetë vetes në shumë nga këto pyetje dhe a mund të sillemi në një mënyrë, e studentëve tu rrëfejmë diçka plotësisht ndryshe.

19. Është e nevojshme sa më pak mësim reproduktiv - sa më tepër mësim të shoqëruar ! Sa më pak të grumbulluar faktesh dhe përjasje kontejnerë informacioneve - sa më shumë asociacione, metaforë, sa më shumë lidhshmëri faktesh, sa më shumë mendime të ndërthurura në tru, sa më shumë të menduar dhe shpjegime faktesh, sa më shumë ide...

20. Qasja e këtillë kërkon përgatitje gjithëpërfshirëse dhe serioze të arsimtarit për çdo orë! Shfrytëzimi i orëve të përgatitura nga vitet e kaluara e rrezikon në masë të madhe kualitetin e mësimit. **Çdo orë është orë në vete! E papërsëritshme!** Andaj, nuk guxon të ketë rutinë! Kuptohet se disa koncepte, definicione, algoritme nuk ndryshojnë aq shpesh. Por duhet ndryshuar konteksti i sqarimit të këtyre konstantave! ... Janë të domosdoshëm shembujt e freskuar. Shembujt nga jeta të cilët studenti mund ti kuptojë.

21. Në ç’ do lëndë duhet ndër lidhja me disiplinat tjera, respektivisht lidhja ndër disiplinare. Ose të themi më mirë ndërlidhja me disiplinat tjera, por edhe me lëmi të shkencës. Asnjë disiplinë nuk duhet të jetë qëllim në vete! Ajo duhet të jetë pjesë e rritjes të **ndërlidhjes së diturisë dhe shkathtësive** të cilat shpjen drejtë ndërlidhjes së aftësive dhe fuqisë krijuese të studentit, drejtë të menduarit dhe rritjes së aftësisë në shpjegimin e fakteve të ndërlidhura.

22. Qasja analitike është e pashmangshme – të mësuarit për pjesët individualisht! Por, është e nevojshme ndërlidhja e tyre “analitike”, e detajeve, e atyre pjesëve , jo në mënyrë mekanike por në mënyrë **holistike** – në proces, natyrshëm, në mënyrë organike; ndërlidhja me kuptim e “detajeve” në kuadër të tërësisë. .. Le ti shmangemi skllavërimit personal me detaje, respektivisht t’i shmangemi asaj që nga druri të mos shihet pylli...

Sintezës së diturive individuale nga disiplina në nivelin e vetë disiplinës , si dhe sintezës së mëtejme të diturisë ( disiplinës), në nivelin e planit tonë arsimor në tërësi duhet kushtuar mjaft kohë dhe kujdes në përgatitjen e orës dhe të mësimit. .. Ky është proces i përhershëm në përsosmërinë e arsimtarëve. Mësim i vazhdueshëm! Përmirësim gjithnjë. Të braktiset principi se disiplina “ **jonë**” është më e rëndësishme dhe se ajo është qëllim për vete! Atë që punojmë në kuadër të një discipline ka kuptim vetëm nëse ajo është e rritëzuar , nëse është e gërshetuar me njohuritë nga lëmit tjera !...Kjo në veçanti ka të bëjë me matematikën , fizikën, kontabilitetin , të drejtën penale, artin...

23. Zgjimi i shpirtit të studentit, insistimi në dimensionin **shpirtëror, arsimor dhe filozofik** në mësimin e çdo disipline, në vend të insistimit dominues në njohuritë ngushtë shfrytëzuese dhe perceptimin mekanik ( bukualisht ) të informacioneve dhe fakteve , është rruga drejtë nxitjes së mëtejme të kualitetit në arsim... Ne, nuk guxojmë që studentin tonë ta përgatisim për një profesion ngushtë-profesional të tanishëm... Ai së shpejti do të humbë... Do të lind e reja... Studentin e përgatisim për rrezik dhe pasiguri, dinamikën globale të pasigurtë, për jetë në ndërvarësi globale... Askush s’ mund të dijë çfarë saktësisht do ti nevojitet studentit! Gjithçka ndryshon... Ndryshimi është konstanta e vetme. Për këtë arsye duhet të përgatisim **ekspertë për pasiguri!** “Çfarë do që të vijë, asaj i jam gati” (Njegoshi).

Ashtu siç nuk mund të lahem dy herë në të njëjtin ujë në lum, ashtu as ajo që ishte e rëndësishme gjatë shkollimit tonë ( arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve) s’ mund të jetë sërish në të njëjtën mënyrë e rëndësishme për studentin tonë... Përvoja jonë si mësimdhënë, nëse nuk përparohet në çdo minutë, mund të jetë barrierë në zhvillimin kualitativ në mësimin tonë... Përvoja e ngrirë nuk do të prodhoj ngrohtësi në shpirtin e studentit .

24. Në ç’ mënyrë studentët, por edhe bashkëpunëtorët dhe arsimtarët të lirohen nga egoja personale? Palanka zhvillonë egon. Egoja është të dashurohesh në vetvete. Egoja në Mal të Zi gjithnjë e më tepër është duke u shndërruar në narcisizëm. Egoja zhvillon ndërgegje të ngushtë. Kuptimi i ngushtë është “ pikëpamja e ngushtuar e jetës dhe realitetit”. Ngushtësia e të menduarit e vret kreacionin, idetë e reja, inventiven ... në ç’ mënyrë nga ego në vetë njohje , vet respektim dhe vet besim? Ky është problemi kyç mental në veçanti për të rinjtë të rritur me teknologjitë e reja për “guximin personal virtual” .

25. Studenti - si të ndërtohet karakteri i tij/saj? Personalitetin e tij! Si të ndërtohet ndjenja e re e vet respektimit ndaj vetes dhe njëkohësisht të bashkë ndiej me njerëzit tjerë? Si të ndërtojmë ndjenjën se shoqërimi dhe miqësia janë platforma të suksesit në jetë? Si të shmangim vërshimin e sotëm të valëve të egoizmit mishngrënës e në veçanti pasionin e njerëzve me modelin e botëkuptimit primitiv (egoist dhe në sasi ) të drejtës sociale, respektivisht angazhimit publik për të drejtën sociale që në mënyrë të padukshme të realizohen disa nga interesat personale?... vështirë se mund të gjendet aq hipokrizi si sikur tek disa “gjoja” luftëtar për drejtësi sociale... studentin duhet larguar nga kjo- duhet zhvilluar tek ai bashkë ndjenjën e vërtet njerëzore ndaj të afërmeve...

26. Në veçanti duhet insistuar në lidhshmërinë ( në mënyrë të përbashkët , organike, përmes shembujve...) e çdo disipline me letërsinë, poezinë, artin, arsimimin e përgjithshëm, kulturën e gjithnjë e më tepër mitologjinë, religjionin, filozofinë dhe historinë...Qasja e këtyre e zgjon **shpirtin** dhe zgjeron **largpamësinë shpirtërore** të studentit. Natyrisht, kjo nënkupton punë të madhe dhe investimin e çdo profesori dhe bashkëpunëtorit në vete, në shpirtin e vet, arsimimin, kulturën... “Arsimtarët e ngrirë” së shpejti do të shkrihen në nxehësinë gjithnjë e më të madhe të energjisë të kërkesave të studentit- studentët do të kërkojnë gjithnjë e më tepër.

27. Procesi ynë mësimorë, koncepti i studimeve gjithnjë e më tepër duhet bazuar në logjikën e sportit dhe **frymën e lojës!** Sporti zgjon natyrën e njeriut, zhvillon përgjegjësinë personale, zhvillon lidhshmërinë mes trajnimit ( angazhimit ) dhe rezultatit e në veçanti përmes logjikës së lojës zhvillohen **aftësitë e inovacionit dhe kreative**, zhvillohet **prodhimi i ideve** dhe që është më e rëndësishmja- logjika e sportit, e kuptuar përmes këtij dimensioni më së shpejti mund të motivojë, thënë më mirë ta zgjojë studentin.

28. Kreacion, kreacion, kreacion; inovacione, inovacione, inovacione; afarizëm, afarizëm, afarizëm! Jeta në dinamik! Jeta që respekton kohën! Jeta në kontekstin e ambientit të cilin e krijojnë zbulimet e mekanikës kuantike dhe fizikës, e gjithnjë e më tepër të biologjisë molekulare dhe kosmologjisë. Jeta, jo vetëm në natyrë-por jetë natyrore.

Si të motivohet studentit? Si të “zgjohet!” Si të ia kuptojmë kureshtjen? këto janë çështjet më të rëndësishme në punën tonë si mësuesdhënës! Në mënyrë klasike, motivimi do të thotë që njerëzit tjerë(studentët)ti motivojmë në sjellje të caktuar, në aktivitet të caktuar, ti ndihmojmë në nxitjen e të menduarit! Të braktisim qasjen e këtyre në motivimin e studentit, edhe pse është e rëndomtë të themi se “dikush dikën duhet të motivojë”. E vërteta është se në raportet mes njerëzish nuk ekziston raporti mekanik i shkakut dhe pasojës, për arsye se gjithkush është përgjegjës për vete se si do të sjellët. Ne më se shpeshti tentojmë të kemi fuqinë të jemi shkak i sjelljes së huaj. Por, fjalët e thata nuk motivojnë. Refleksi i Pavlovit- shpërblimet e imta të cilat veç i “promovon” modeli i deklaratës së Bolonjës, e të cilën njerëzit e pranojnë me kënaqësi nuk shpie drejt kreacionit por inercionit dhe imitacionit. A nuk është hipokrizi të shpërblehet studentit se ka ardhur në orë? A nuk është kjo puna e tij? A thua shprehin nga palanka se “rroga merret për shkak të ardhjes në punë, e jo për shkak të rezultateve” guxojmë ta fusim në sistemin arsimorë.

Në mënyrë që porosia jonë të jetë e prekshme për studentin, ajo duhet të prekë **sistemin e vlerave** të tij. **Emocionet** e tij...Nëse porositë tona nuk kanë të bëjnë me asgjë të rëndësishme për studentin, ato nuk do të ndikojnë në të. Dhe anasjelltas! Për këtë arsye është e rëndësishme njohja e sistemit të vlerave të studentëve të gjeneratës së re, jo që ta vlerësojmë a është i mirë apo i dobët por përmes tij ti dërgojmë studentit porositë të cilat do të ndikojnë në aftësitë e tij, kompetencat, kreacionin. Vërtetë, teknika e rëndësishme e motivimit është shembulli ynë personal, UNË dhe respektimi i përpiktë i rregullave të studimeve të miratuara më parë dhe që u janë prezantuar studentëve... Gjithnjë e më tepër duhet të kuptojmë sociologjinë e emocioneve.

29. Lidhshmëria e emocioneve dhe mësimi, respektivisht studimit është duke u hulumtuar gjithnjë e më tepër. Rezultatet e këtyre hulumtimeve vërtetojnë nevojën të shfrytëzojmë **mësimin respektivisht studimin emocionalisht të ngjyrosur**. Neuroshkencëtarët gjithnjë zbulojnë njohuri të reja në hulumtimin e emocioneve si përbërës të mësimi. Ana afektive e të mësuarit është e rëndësishme në lojën e ndenjave tona, funksionimin dhe të menduarit. Nuk ekziston ndarje e të kuptuarit dhe emocioneve. Emocionet , të menduarit dhe mësimi janë ngushtë të lidhura... Nuk guxojmë që emocionet ti konsiderojmë më pak të vlefshme, që është trashëgimi e Perëndimit. I qëndrueshëm, i

besueshëm “rruga shkencore” ka qenë rruga e të kuptuarit dhe logjikës. Shkenca merret me fakte, e jo me ndjenja. Për këtë arsye shumica edhe më tej konsideron se hulumtimi i emocioneve dhe kyçja e tyre si përbërës të të mësuarit është vetëvrasje profesionale. Mendoj se shumica e arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve mendon ngjashëm... Për këtë arsye ligjëratat dhe komunikimi me studentë edhe më tej janë stereotipe, me mjaftë konstruktivizëm, të drunjtja! Pa metaforë, asociacione, tregime nga jeta pa zgjimin e imagjinatës, pa “qitjen” e studentit nga gjiri inertë... Studentët duhet zgjuar emocionalisht, e jo për ti vu në gjumë duke i bombarduar me fakte (më se shpeshti duke mos sqaruar kuptimin dhe zanafillën e tyre), duke e dëbuar që mendimet e tij të bredhin, edhe krahas asaj se ai rregullisht e përcjell orën. A thua arsimtari apo bashkëpunëtori i cili me fjalë, shikim, zërin dhe tonalitetin nuk tregon dhe nuk rrezaton energji mund të zgjojë emocionalisht studentin? Mos të harrojmë, emocionet ndihmojnë arsyen për të përqendruar mendjen dhe të përcaktoj prioritetet. Pjesa jonë e logjikës thotë “vendos qëllimet”, por neve vetëm emocionet na **pasionojnë** mjaftueshëm që të veprojmë dhe të arrijmë qëllimet. Si ta zbatojmë këtë në vete dhe në studentët? Si të shkojmë në orë me **pasion**, me **dëshirë të pasionuar** ti themi vetes se mund të nxisim edhe të tjerët ashtu siç kemi nxitur veten?... Lidhur me këtë komponentë do të flasim më tepër me angazhimin e specialistëve nga lëmi i neuroshkencës dhe kjo komponentë gjithnjë e më tepër do të jetë e rëndësishme për vlerësimin e rezultate pedagogjike të arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve dhe bazë për vazhdimin e kontratës.

30. Si ta zhvillojmë inteligjencën emocionale (Goleman), e cila shpije drejt inteligjencës sociale? Edhe pse jemi individë, edhe pse veten mund ta radhis në ata të cilët në individin shohin forcën primare të shoqërisë, megjithatë jetojmë në bashkësi. Jetojmë në planetin e cila është gjithnjë e më dendësisht e banuar, por e cila është në lidhshmëri teknologjike. Gjithnjë e më tepër ndihet ekstremizimi i principeve të individualitetit e cila më së shpeshti është duke marrë karakteristikat e “egoizmit mishngrënës” humbja e ndjenjës për të tjerët, shkrirja e bashkë ndjenjave dhe solidaritetit, harresa e fakteve se interesat tona dhe liria jonë janë të kufizuara me interesat dhe lirinë e të tjerëve - njerëzve me të cilët jetojmë dhe punojmë në një bashkësi. Vërtetë, koncepti i inteligjencës emocionale nuk ka kurrfarë lidhjeje me konceptin e sotëm të drejtës sociale formale, të drejtës burokratike, të drejtës të cilën e përfaqësojnë dembelët dhe mishngrënësit e kamufluar!... Çfarë është kjo drejtësi dhe lufta për të drejtën, pa kyçje të emocioneve dhe pasionit të vet?... Për çfarë drejtësie sociale flasin ata të cilët nuk dinë çfarë është dashuri për të tjerët?

Një formë e inteligjencës emocionale është edhe **përkushtimi i UDG**, frekuentimi dhe iniciimi i aksioneve shoqërore, edukimi emocional i studentëve tonë. Si arsimtarë dhe bashkëpunëtorë sa e investojmë veten, emocionet e veta në inkurajimin e shoqërimin të studentëve, socializimin e tyre, kulturën e tyre në hapjen e të menduarit dhe sjelljes?... Çfarë është kufizimi kyç i psikës të cilën e formon mjedisi i vogël e po ashtu edhe i mbyllur, siç është Mali i Zi? Përse gjithçka që vjen nga jashtë Malit të Zi, trajtohet si “dhuratë e Zotit” e gjithçka që iniciohet nga njerëzit nga Mali i Zi, përjetohet si “dënim nga Zoti”? Vallë, a nuk është kjo mungesë e inteligjencës emocionale? Mungesë e sinqeritetit! Si të krijojmë kushtet që tek studentët e UDG të thyhet kjo ngushtësi, kjo “frymë e palanikë” e cila si mbështjellës i tejdukshëm nguron mendimin e tyre por edhe mendimin tonë, kreativitetin, iniciativat, afarizmin? ...

31. Si të zhvillojmë tek studenti pasionin dhe kureshtjen? Në botën globale, “botën si pllakë e rrafshët” (T.Fridman), pasioni dhe kureshtja janë gjithnjë e më të rëndësishme se inteligjenca! Kuptohet, IQ është i rëndësishëm por RQ- koeficienti i kureshtjes dhe SQ- koeficienti i pasionit, janë edhe më të rëndësishëm. Studenti i cili mëson me pasion dhe është kureshtarë do të përparojë më shpejt se studentin me koeficientin më të lartë të inteligjencës. Studentët kureshtarë dhe të pasionuar e inkurajojnë vetë veten dhe janë të aftë të mësojnë nga përvoja personale, respektivisht nga jeta!... Mos të harrojmë se puna është e rëndësishme por kureshtia është edhe më e rëndësishme. Askush nuk mëson më me zell se studentin kureshtarë. Për këtë arsye muret dhe tavanet e UDG janë “plotë” me

posterë të ndryshëm, me mendimet e njerëzve të rëndësishëm, sqarimin e proceseve, me ç'gjë dëshirojmë të zhvillojmë kureshtjen dhe pasionin drejtë arritjeve të veta hulumtuese? A thua profesorët dhe bashkëpunëtorët në orët e tyre nuk do të duhej, që pikërisht, përmes shembujve dhe mënyrës së komunikimit, të ndikojnë në rritjen e emocioneve tek studentët?... Të mos hyjmë në studimore pa energji e cila zmadhon kureshtjen dhe pasionin tek studenti... Natyrisht, këtë embrion duhet ta kemi në vete dhe kjo është njëra nga karakteristikat shumë të rëndësishme për angazhim në UDG.

32. Përgjegjësia e mësimitdhënësit për suksesin e studentit gjatë studimeve nuk është aq e madhe, sa është e madhe përgjegjësia jonë për suksesin e tyre të ardhshëm në jetë dhe karrierën profesionale. Duket e çuditshme! Mësimitdhënësit tek studenti në masë të madhe transmetojnë sistemin e vetë të vlerave, vetitë e karakterit, mënyrën e të menduarit... E kjo pikërisht është ajo që në mënyrë afatgjate ndikon në jetën e studentit... Natyrisht, e gjithë kjo zberthehet në afat të shkurtër: provime dhe mësim, respektimi preciz i afateve, ligjëratat e përgatitura mirë, organizmin e provimeve, dres-kodi, kulturën e mirësjelljes, mënyrën e komunikimit...

Cilat janë ato gjëra në të cilat ne, arsimtarët, duhet të kemi kujdes? Para së gjithash, në sjelljen tonë!!! Vetëm atëherë një gjë të tillë duhet të presim dhe të kërkojmë nga studentët! Në **shembullin personal duhet punuar dhe investuar më shumë** ! Me shembull personal duhet të dëshmojmë respektimin e rregullave, afateve, dres-kodit, rregullat e organizimit të provimeve, të u drejtohem studentëve me "Kolegë, Ju,..."; që me punën personale ti tregojmë studentit se edhe ai duhet të veprojë ngjashëm...Nuk mund të kërkojmë nga studenti atë që nuk kërkojmë nga vetja dhe atë që vetë nuk e bëjmë dhe nuk e respektojmë.

33. Ndaj studentit duhet të kemi raport profesional. Të shmangim çfarëdo qasjeje prindërore apo mbrojtëse. Të mos kërkohet nga arsimtari apo bashkëpunëtori që autoritetin e vet ta ndërtojë përmes lëshimeve, kuazi kujdesit për studentin përmes "mirë bërjes" malazeze... **Përgjegjësia personale ,shembulli personal dhe raporti profesional!** Me respektimin e personalitetit të studentit, respektimin e të drejtave, por edhe insistimi në përgjegjësitë dhe obligimin e studentit.

34. UDG është **rrjetë kontratash**. Kontratave mes pronarëve juridik (rreth 10 sish); mes fakulteteve; mes universitetit dhe studentit; kontratat me partnerët afaristë... Kontrata është vullnetare dhe e lirë zgjedhje me dëshirë e palëve kontraktuese e shprehur në kuadër të dispozitave pozitive kushtetuese dhe ligjore... Kontrata profesionalizon raportet brenda UDG në të gjitha nivelet. Kjo do të thotë se nuk ka hapësirë për arbitraritet dhe shkeljen e rregullave dhe dispozitave të kontratës pa sanksione. Nuk ekziston hapësirë për pushtet diskrecional të askujt - pronarëve, individëve apo organeve të UDG! **Respektimi i kontratës si vullnet i shprehur lirisht është principi fundamental në funksionimin e UDG.**

35. Duhet të jemi të vetë dijshtë për 2 fakte: (1) në UDG ofrojmë kushtet, jo vetëm ambientin, pajisjet, teknologjinë, por edhe organizmin dhe metodat e mësimin, kuadrin mësimorë i cili është **në nivelin më të lartë nga niveli që kanë shumica e universiteteve në rajon**; (2) studentit ynë paguan studimet, më së shpeshti me paratë e prindërve të vetë. Andaj, a guxojmë ne si arsimtarë të lejojmë që studentit ynë të mos shfrytëzojë këtë mundësi jetësore që i është dhënë? A mund të jemi indiferent ndaj faktit që ata na kanë zgjedhur ne dhe këtë zgjedhje e kanë paguar? Të rrisim nivelin dhe kualitetin e punës, ti kushtohemi studentit, të nxisim secilin studentë dhe ti zgjojme ata, ta ndihmojmë të tejkalojë mos interesimin e mundshëm momental... Ta motivojmë të punojë sa më shumë, por edhe të kënaqet në studime, ta ndihmojmë të zhvillojë vizionin e vet...Të përfundojë studimet me sa më shumë dituri dhe shkathtësi, me mundësi kreative, me kompetenca sa më të mëdha...Dhe mbi të gjitha me **pasion sa më të zhvilluar për vetë arsimin**. Pa këtë pasion, nuk mund të ketë arsim gjithë jetën (Life long learning ).

36. Të motivojmë studentin që nga fillimi i studimeve të kuptojë dhe të punojë në pajtim me standardet që kërkojnë studimet e magistraturës (3+2), e ata më të mirët (3+2+3) ti përgatisim për standardet e kërkuara në studimet e doktoratës. Në të gjitha komunikimet me studentët duhet theksuar nevojën që të ndërtojnë **vizionin** e vet, të shohin veten përtej horizontit të kësaj përditshmërie të zbehtë dhe atë më të zbehtë “filozofia e palanikë”... Natyrisht, kjo nënkupton se edhe **ne vetë** si arsimtarë dhe bashkëpunëtorë në jetën tonë kemi tejkaluar “filozofinë palanikë”.

37. Në veçanti vërejtje për kolegët e ri dhe bashkëpunëtorët: shumë më tepër duhet punuar në vetë ngritje, duke lexuar, hulumtuar, publikuar, paraqitje publike dhe të jetohet, jetohet, jetohet – **kështu të ndërohet vetja dhe të vihet deri tek vetja**. Të vihet deri te shansi të jeni profesor të universitetit- për këtë janë të nevojshme më së paku 15 vite punë të përditshme, nga së paku 10 orë dhe po aq orë të arrini përvojën. Vrapimi pas diplomës dhe titujve gjithsesi nuk ka kaluar, por në UDG nuk do të tolerohet. Duhet dalluar profesorin me vokacion dhe profesion në shpirt nga profesori me profesion momental. UDG si universitet privat ka ardhmëri vetëm nëse të gjithë punojmë me kualitet dhe do ti kushtohemi zhvillimit personal, para se gjithash atij shpirtërorë, duke shfrytëzuar kushtet dhe shanset që ofron UDG dhe që do të ofrojë çdo ditë... Të mos harrohet se konkurrenca është gjithnjë e më e madhe, se në konkurset tona paraqiten edhe ekspertë nga jashtë... **Nuk ekziston angazhim i përjetshëm në universitet-në UDG në veçanti**.

38. Duhet shmangur kërcimin i çastit nga, në të vërtetë me sukses, të studentit të diplomuar deri te “profesori i madh” dhe duhet shmangur imitimet e profesorëve të vet, nuk duhet dhëna këshilla të mëdha studentëve, këshilla që nuk i keni arritur përmes përvojës personale. Nuk duhet lavdëruar me flatrat e huaja, aq më tepër me imagjinatën personale dhe të dashuruarit në vetë vete. Narcisizmi intelektual më së shpeshti është dëshmi e papunës ose punës jo të mjaftueshme në vete, vërteton shprastësinë në dituri dhe mungesën e kreativitetit dhe inovacionit praktikë, të një apo pak librave të lexuar, dëshmi e mungesës së shpirtit dhe kujdesit ndaj shpirtit të vetë...

Rruga e krijimit të profesorit të mirë dhe hulumtuesit nga bashkëpunëtori fillestarë është shumë e ngjashme me rrugën e formimit të mjeshtrit të mirë (këpucëtarë , floktar , farkëtarit apo menaxherit) nga nxënësi fillestarë. Praktika (në gjuhën moderne “praktikant”) është proces i të mësuarit hap nga një hap dhe në përvojën personale, nën syri e mprehtë të mjeshtrit... A e ka çdo bashkëpunëtorë i ri ose relativisht i ri mentorin e vet?... Në çdo fazë ose moshë duhet pasur mentorin-atë që u kalit vizionin dhe u zgjon kreativitetin... Nuk është fjala vetëm për mentor në tezë...Fjala është për **personin frymëzues!** Përvoja e dëshmon se të gjithë ata që kanë dëshiruar që sa më shpejt të lirohen nga mentorët e vet, edhe më shpejt kanë dështuar .

39. Duhet shmangur qasjes së mësimi: kam ligjëruar gjithçka, kam dhënë literaturën, afatet për provim, vetëm pres studentët... duhet kërkuar reaksionin kthyes nga studenti-çfarë kanë kuptuar, e çka jo, çfarë duhet avancuar te secili studentë **individualisht**...Mësimi dhe raporti me studentin duhet të jetë **interaktiv!** Në këtë raport duhet respektuar edhe dijen dhe mos dijen e studentit. Studenti ka të drejtë në mos dije dhe mos dija nuk guxon të jetë shkak për çfarëdo kualifikimi që do të mund të fyej dinjitetin dhe lirinë e studentit, sidomos jo për thashetheme rrugësh që janë veçori e frymës palanikë. Duhet të ruajmë privatësinë e studentit. Për mos dije jepet notë adekuate. Mos dija e studentit duhet të jetë sinjal që ai të ndihmohet në punë, të inkurajohet për angazhim shtesë gjatë studimeve dhe të ngjashme.

40. Studentët pavarësisht në suksesin e arritur, nga shkolla e mesme vijnë me shprehitë e mësimi reproduktiv (grumbullimi i fakteve ), me aftësi të vogla për lidhshmërinë e fakteve dhe informacioneve me të cilat disponojnë, me fond modest të fjalëve, me përvojë të vogël në përdorimin e lapsit dhe të letrës, me shprehinë që për një çështje mund të shkruajnë një ose më së shumti dy fjali të shkurtra, me

nivelin e ulët të kureshtjes, me frikën nga e reja, me frikë që të parashtrojnë pyetje dhe të komentojnë e të ngjashme... A duhet “mëshuar” mbi ta me mësimin klasik dhe me profesorin e vrenjtur, i ashpër në komunikim, apo me studentin duhet biseduar hap nga një hap, për tri vite-në mënyrë **evolutive (gradualisht)** të mënjahohen disa nga këto mangësi, të avancohen vetitë pozitive të tyre dhe talenti! Studentin nuk duhet edukuar që në mënyrë dominuese me e dënuar me nota të dobëta, por të “dënohet” me kërkesën që sa më shumë të punojë përmes metodave të mësimi interaktiv!!!

41. Mos lidhshmëria e informacioneve në trurin e studentit është pengesë kyçe në rritjen e aftësive të tij dhe kreativitetit... Si ti aftësojmë ata në prirje që të thurin njohuritë të lidhin informacionet e ndryshme në **një tërësi**, që përmes lidhshmërisë së njohurive personale **të prodhojnë ide të reja**. Thurja dhe lidhshmëria e njohurive në trurin e studentit, krijimi i **rrjetit mental** të tij - është në qendër të fillimit të mësimi në universitet... Secili profesor dhe bashkëpunëtorë duhet të gjurmojë metodat që i përgjigjen karakterit të tyre dhe karakterit të lëndës. Të mësuarit përmes asociacioneve dhe metaforës... Shqyrtimi i artikujve, librave ,debatet, recitimet...

Përdorimi masiv i teknologjisë moderne në këtë kontekst pothuajse gati i ka bërë të pakuptimta detyrat shtëpiake, esetë e të ngjashme...Në mbarë botën është në skenë përshkrimi masiv-nga detyrat shtëpiake deri tek tezat e doktoratës. Duhet tentuar që studentët detyrat shtëpiake ti punojnë në studimore ose bibliotekë me vërejtjen që bashkëpunëtorët dhe profesorët ti hartojnë detyrat shtëpiake në mënyrë që të nxisin kreativitetin e studentit, të kërkojnë që studenti të dëshmohet, të lirohet nga përshkrimi...Kjo është logjika e modelit që **studenti tërë ditën ta kalojë në universitet**. Kjo edhe është qëllimi i deklaratës së Bolonjës! Ne i kemi kushtet për këtë! Pse nuk i shfrytëzojmë më shumë ? Studentin duhet mbajtur sa më shumë gjatë ditës në universitet!... Të jetojë në mjedisin intelektual, akademik siç është në UDG, jo nëpër kafene, në qendra tregtare e të ngjashme. Kjo ishte ndër arsyet që UDG është ndërtuar në lokacionin e sotëm- larg nga zhurma e qytetit dhe kafenetë.

42. Respektimi i **“13 urdhërimeve”** për hyrje në provimet me shkrim në UDG është obligim “biblik”. Nuk ka interpretim kreativ për fijet e këtyre urdhërimeve dhe të asnjë rregulle të studimeve. Kreativitetin e vet profesorët dhe bashkëpunëtorët duhet ta dëshmojnë në mënyrën e organizimit të mësimi, komunikimin me studentë, hulumtime, në publikimin e shkrimeve dhe të librave... Secili arsimtar dhe bashkëpunëtor ka nënshkruar Kontratën për angazhim , si shprehje e vullnetit të lirë i njoftuar apriori me rregullat dhe filozofinë e punës në UDG. Kuptohet, të gjithë jemi të ndryshëm dhe mospajtimin eventual apo mospranimin , duhet shprehur para nënshkrimit të kontratës. “13 urdhërimet “ duhet respektuar në mënyrë të përpiktë , e nëse ka propozime për ndonjë ndryshim, ekziston procedurë e qartë për këtë. **Por gjithnjë derisa të ekzistojnë këto “ 13 urdhërime “, ato duhet të respektohen.** Duhet ditur, bashkëpunëtorët në veçanti, se studentët më së tepërmi respektojnë profesionistët , e ata të “ mirët” dhe “mirëbërësit” , herët a vonë nuk i respektojnë , e që shkon deri në përbuzje.

43. Kujdes të veçantë duhet kushtuar punës në tezat për specializim, të magjistraturës dhe të doktoratës. ( Kjo dhe principet e hulumtimit do të përpunohen në veçanti). Tema e punimit, struktura e sajë, mënyra e hulumtimit dhe puna me mentor duhet të jenë pengesë për çfarëdo **qëllime të dyshimta të studentit**, çfarë ka sot përreth gjithnjë e më tepër . Është e tepërt të thuhet se identifikimi kyç i universitetit arrihet pikërisht në këto nivele të studimeve. Për këtë arsye të gjitha shkeljet nga kjo lëmi i nënshtrohen përgjegjesisë penale të studentëve, profesorëve dhe bashkëpunëtorëve... Kjo është ndër dispozitat e Kontratës për angazhim dhe Kontratës për studime, të cilën e kemi nënshkruar të gjithë.

44. Çfarëdo forme e mos transparencës , mbrojtjes apo proteksionizmit, lirisë së tepruar në zbatimin e rregullave , rrezikojnë imazhin e Universitetit tonë, e kjo do të thotë edhe imazhin e studentit tonë të diplomuar, por edhe të çdo profesori , bashkëpunëtorit dhe të punësuarit në UDG ! Askurrë të mos harrohet **përgjegjësia personale** gjatë punës në Universitet! Të mos harrohet askurrë se ju e ndërtoni imazhin e UDG! Të mos harrohet askurrë se kritika drejtuar kujt do qoftë në UDG, duke filluar nga pronarët deri tek arsimtarët dhe studentët, është kritikë edhe për Ju personalisht, për Ju si profesorë, bashkëpunëtor apo studentë.

45. Duhet rritur numrin e gjuhëve të huaja të cilat i njohin dhe me të cilat shërbehen profesorët dhe bashkëpunëtorët. Natyrisht edhe studentët! Por, nuk mund ti “detyrojmë” studentët të mësojnë gjuhët e huaja , të cilat arsimtarët dhe bashkëpunëtorët nuk i njohin aq sa duhet. Duhet të jemi të gatshëm në mësimin komplet në **gjuhën angleze** në dy – tri vitet e ardhshme . Por, së shpejti edhe në gjuhë tjera. Ky është kushti që gradualisht të tërheqim edhe studentët nga jashtë ! **Të zgjerojmë tregun** tonë nga i cili jetojmë dhe zhvillohemi! Arsimtari dhe bashkëpunëtori i cili është i vetëdijshëm për investimin personal në mësimin e gjuhëve të huaja mund të jetë shembull për studentët që edhe ata të mësojnë më shumë gjuhë të huaja. **Sa bashkëpunëtorë të UDG në këtë moment janë duke mësuar ndonjë gjuhë të huaj, sepse gjuha angleze nuk është gjuhë e huaj?** Gjenerata e sotme e studentëve është gjeneratë në të cilën ndikohet, jo me fjalë, por me **shembull personal!** Mënyra e punës së Qendrës për gjuhët e huaja, e cila është akredituar nga shteti , organizimi i saj, çmimi i ulët dhe profesorët e mirë, janë shanse të shkëlqyera për secilin në përsosjen e njohjes së gjuhëve të huaja. Nga viti i ardhshëm ( regjistrimi), kusht për marrjen e diplomës në UDG, do të jetë njohja e tri ( 3) gjuhëve. Gjeneratat e sotme të studentëve duhet të njohin 4-6 gjuhë që të jenë konkurrent në jetën e tyre të punës. Ndërkaq, shihni konkurset për hulumtime në vendet e UE, por edhe në shumicën e kompanive! Gjithkund kërkohet njohja e 3 e më tepër gjuhëve! E të mos flasim për vitin 2030, kur studentët e tashëm do të kenë 35 -40 vjet! Pse të mos i përgatisim tani për atë kohë?!

46. Avancimi i hulumtimeve(shkencës) gjithnjë e më tepër është në fokus të rritjes së kualitetit të mësimin në universitet. Hulumtimet janë pjesë përbërëse e procesit mësimorë! Ato janë pjesë e pa ndashme të  $S = z \cdot i^2$  ! Kjo nënkupton para së gjithash të kyçurit e studentit në punën shkencore dhe zhvillimi i aftësive hulumtuese të studentit, e në anën tjetër publikimin e sa më shumë punimeve në revistat referente, që është e rëndësishme për imazhin dhe rangimin e Universitetit. Pa botimin e artikujve në revistat referente nuk ka zgjedhje as rizgjedhje të profesorëve. Humbet e drejta të jetë mentor për tezat e doktoratës, e drejta në aftësimin e post doktoratës dhe stipendime të reja... Të shikojmë përpara që të mos jemi viktimë e të ardhmes e cila ka filluar... Pyes të gjithë arsimtarët dhe bashkëpunëtorët sa janë personalisht të kyçur dhe sa kanë kontribuar që studentët e tyre të kuptojnë rëndësinë e **Ditës së hulumtimeve në UDG**, e cila shënohet në çdo 04. prill, në ditën e studentëve.

47. Aftësitë informatike dhe shkathtësitë e të gjithë bashkëpunëtorëve dhe studentëve të UDG duhet përmirësuar, e në pajtim me programin që përgatitet në FIST ! Kalimi nga **ekonomia industriale në atë informatike, nga shoqëria industriale në atë informatike** është shumë më tepër se ajo në çka duan të na bindin informaticientët të cilët theksin e kanë në mekanikën dhe në hardver, në kuptimin e informatikës si tregti të “makina të mençura”. Jo - kjo është paradigma e re abstrakte në kuptimin e botës që na rrethon dhe sjelljes në të. Hyrja në periudhën e re-“periudhën e qasjes”(J. Rifkin)

48. Shkuarja në orë nuk është e njëjtë me shkuarjen në ndonjë mbledhje në të cilën shkohet pa ndonjë përgatitje dhe në vetë mbledhje improvizohet diskutimi. Ora kërkon përgatitje të plotë, pa improvizime dhe mungesën abstrakte nga ora, kërkon mënjanimin e fjalëve dhe fjalive të thata, si dhe mënjanimin e shprehjeve palanikë si dhe admirimin e shundë produksioneve dhe interpretuesve të sajë, e po ashtu



mënjanimin e çfarë do diskutimeve politike. Ora duhet të përgatitet sipas principit se **asgjë nuk duket spontane dhe e natyrshme sikur ajo që është e përgatitur mirë!**

Ora është punishte në të cilën punojnë studentët, ushtrojnë, e jo të përcjellin në mënyrë pasive dhe të bredhin me mend. Detyrë e çdo arsimtari dhe bashkëpunëtori është që studentin, si të mundët dhe të dijë, ta kycin aktivisht në këtë punishte. Arsytimi se- “studentët këtë nuk e duan”-më tepër e dëshmon mos aftësinë e arsimtarit ose bashkëpunëtorit dhe sipas të gjitha gjasave kjo do të jetë shkak që me arsimtarët dhe bashkëpunëtorët e tillë të rishqyrtohet Kontrata e deri te shkëputja e sajë... Mendimi se për arsimtarin mjafton të arrijë titullin, e të lihen anash aftësitë pedagogjike dhe edukative dhe të jetë pa entuziazëm profesional në studimore, çon drejtë “vrasjes” të mësimit, respektivisht ambicieve dhe vizionit të studentit... E kjo në UDG nuk mund të tolerohet!

49. Mësimi në UDG është i **obliguar!** Të gjitha aktivitetet në UDG janë të **obligueshme!** Obligimet janë rregulluar me **kontratën për studime**. Studenti apriori njihet me rregullat të cilat janë të rregulluara me kontratën. E ka lirinë të zgjedhë të regjistrohet ose mos të regjistrohet në UDG. Nëse regjistrohet në UDG, raportet janë të rregulluara me Kontratën për studime. Hyrja në kolegji dhe provime nuk është e mundur nëse nuk ekziston evidenca e qartë e nënshtruar kontrollit lidhur me prezencën. Çfarë do shpjegimi kreativ të këtij obligimi nga ana e arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve është shkelje e disiplinës, që ka për pasojë shkëputjen e kontratës për punë ose angazhim. **Mes tjerash, prindërit që paguajnë studimet presin që fëmijët të jenë në mësim në UDG, e jo diku tjetër duke rrezikuar të jenë të përfshirë nga çmenduritë dhe veset e kohës në të cilën jetojnë.**

50. Shfrytëzimi i video-bimit duhet të jetë i **kufizuara**. Vetëm fjalia e shkurtër, fjala, fotografia, grafiku... Nëse në sllajd gjendet gjithçka që profesori dëshiron të thotë-nëse arsimtari lexon sllajdin-vëmendja e studentit përqendrohet në sllajd kurse profesori as që do të vërehet. Studenti, sipas rregullës, nuk shënon asgjë, i humbur shikon në sllajd, sjellët sikurse në kinema... Profesori e humbë autoritetin dhe mundësinë që të motivojë studentin, që tanxisë atë . Për këtë arsye përdorimi klasik i tabelës me shfrytëzimin e kufizuar të sllajdeve dhe me shënimin nga studentit të disa fjalëve, ideve, mendimeve dhe literaturës së preferuar, është shumë e dobishme! Me çdo kusht duhet ndaluar që studentit të përgatisë provimet në bazë të sllajdeve!... Libri, libri, libri, fletorja, hrestomatia, debati, diskutimet... Natyrisht këtu është e obliguar prezenca në mësim-“fjala e gjallë”!

51. Në çdo lëndë duhet zhvilluar mësimin e **fjalëve!** Kuptohet, për fjalët më të afërta asaj disipline, por edhe të tentojnë që secili student të japë definicionin e vetë të asaj shprehje - kuptimin e tij... Qëllimi është pasurimi i fjalorit dhe zhvillimi i të menduarit abstrakt... Të kuptuarit e fjalëve është bazë për të kuptuar fjalitë - e që është mënyra e të shprehurit të mendimeve! Si të kuptohet mendimi që sjell fjalia nëse në esencë nuk kuptojmë fjalët në fjali?

52. Orari i fillimit dhe përfundimit të orës duhet respektuar me përpikëri. Nuk mund të ketë vonesë e as vazhdim të orës! Studentin duhet mësuar në respektimin e agjendës dhe të orarit , e që do të kërkohet nga ata në mjediset me profesionalizëm të lartë pas përfundimit të studimeve.

53. Dekanët e fakulteteve, kohë pas kohe, janë të obliguar të prezantojnë në mësim, jo vetëm në fakultetet e “veta”. Moto e imja është: **“Besimi është punë e mirë, por kontrolli është njëqind herë më i mirë dhe më efikas”**. Të njëjtin obligim e kryen edhe Rektori i universitetit, pavarësisht çudisë që shkakton paraqitja e tij në studimore. Ky është kontributi ynë konceptit (idesë) të evoluimit të brendshëm në kualitetin e studimeve.

54. Shembujt e lidhshmërisë së profesorëve dhe bashkëpunëtorëve nga fakultetet e ndryshme në Universitetin UDG, ( projektet, mësimi, sporti, shoqërimi,...) inkurajojnë lidhshmërinë dhe rrjetëzimin në fakultetet e ndryshme të UDG ( tash për tash 12). Rrjeti afarist ( “ **rrjeti i shokëve të vjetër**”), është njëra ndër dobitë e rëndësishme për studentin e UDG! UDG është ndër universitetet e rralla, fakultetet e të cilit janë **në të njëjtën ndërtesë!** Ngushtësia e ndonjërit nga fakultetet (mos komunikimi me idetë e fakulteteve tjera në UDG) mund të dobësoj kualitetin e studentit të tij por edhe imazhin e UDG. A thua mendon ndokush se do të tolerohet kjo? Snobizmi, në bazë të klerarkisë së nevojave, sipas Masllovlev, është nën nivelin e kreativitetit, prodhimit të ideve të reja dhe respektimit të vetes, në ç’ gjë insistohet në UDG.

55. Është e nevojshme të vazhdohet, por edhe të intensifikohet bashkëpunimi **me prindërit e studentëve**. Kjo është njëra ndër përparësitë e mëdha të UDG në krahasim me fakultetet në rrethinë. Mirëpo, duhet futur obligimin që në mesin e semestrit ( dimëror dhe atij të verës ) të komunikohet me shkrim me prindërit, në mënyrë që prindërve tu japim informacion për prezencën në mësim, aktivitetet, kulturën e sjelljes, suksesin e arritur të studentit. Kjo në veçanti ka të bëjë me studentët e vitit të parë për të cilët duhet zbatuar obligimin dhe në semestrin e parë të kontaktohen prindërit, së paku dy herë. Të mos harrojmë se disa nga prindërit duke paguar shkollimin, na kanë dhuruar besimin dhe shpresën të ndihmojmë fëmijët e tyre të bëhen ekspert, por edhe njerëz të mirë dhe të shëndosh.

56. Si të vendosim bashkëpunimin me **shkollat e mesme**? Përgjigja në këtë pyetje është njëri nga parakushtet për ngritjen e kualitetit të mësimit në UDG. Ky bashkëpunim duhet të jetë shumë më tepër se niveli i politikës së regjistrimit. A thua se përvoja nga forumi zhvillimor i Milloçerit, nga viti i kaluar ( 2013 ), kushtuar zhvillimit të arsimit, në të cilin, mes tjerësh, prezantoi një numër i madh i profesorëve nga shkollat e mesme, mund të jetë njëra nga format e këtij bashkëpunimit? A duhet pas aksione të përbashkëta, ligjërata, konferenca, seminare ? A do të mundemi që në disa shkolla të mesme të zhvillojmë aktivitete në përgatitjen e nxënësve të interesuar për mësim në UDG ? Si ti kyçim arsimtarët më të mirë nga shkollat e mesme në mësimin në UDG ? A duhet që arsimtarëve nga shkollat e mesme tu adaptojmë regjimin e mësimit në studimet post diplomike dhe të doktoratës ? Kualiteti i arsimtarit në shkollën e mesme ndikon shumë në kualitetin e mësimit në universitet, përmes kualitetit të nxënësve të tyre. A thua se, tashmë, nuk “njihen shkollat” në bazë të kualitetit të nxënësve të cilët dalin nga ato dhe vijnë në UDG ? Të gjithë arsimtarët dhe bashkëpunëtorët në UDG duhet të kontribuojnë në avancimin e këtij bashkëpunimit. Do të organizohet tryezë e rrumbullakët në këtë temë në të cilën do të ftojmë edhe përfaqësuesit e të gjitha shkollave të mesme në Mal të Zi.

57. Në kuadër të realizimit të konceptit  $S=z * i^2$  lidhje me **biznesin, institucionet shtetërore, organizatat ndërkombëtare, ambasadat** dhe të ngjashme, është shumë e rëndësishme. Kycja e njerëzve nga praktika në mësim, shkuarjes së studentëve tonë në praktik duhet ti paraprijë kycja e profesorëve dhe bashkëpunëtorëve në jetën reale ekonomike, etj. Koha e profesorëve të mbyllur në kabinete të mëdha e të cilët me mos respekt shikojnë në praktikë, është në kalim e sipër! Profesorët e tillë nuk do ti paguajë askush! Gjithnjë e më pak edhe shteti!...

58. Principi themelor i punës dhe jetës në UDG është **liria**. Përgjegjësia! Liria personale! Liria e shpirtit! Liria e krijimtarisë! Liria e ideve! Liria e të liruarit nga egoja personale! Liria e zgjedhjes! Liria e cila prodhon dallimet! Liria e kuptuar si “e drejta në mos barazi” (N.Bergjajev). Liria pa frikë nga liria! Liria në kundërshtim me idetë e Erik From, në veprën “Ikje nga liria”! Liria nga frika nga politika! Liria nga frika nga “barazia mekanike”! Liria në UDG do të thotë obligim në marrjen e përgjegjësive personale për pasojat e aksioneve personale dhe sjelljes personale, dhe se liria personale është e kufizuar me lirinë personale të njerëzve tjerë.

59. Në UDG afirmohet sjellja kreative. Inkurajohet marrja inteligjente për sipër e rrezikut dhe në kuadër të kësaj pranimi i të drejtës në gabim. Të liruuar nga frika për të gabuar, studentët, arsimtarët dhe bashkëpunëtorët nuk frikohen të tentojnë, të fusin diçka të re.

Ne afirmojmë mendimin e Ajnshtajnit se ai nuk është i njohur për zgjidhjen e ekuacionit  $E=m \cdot c^2$ , por për **mijëra tentime me të cilat ka vërtetuar se ky ekuacion “nuk punon”** ! Si të lirohen njerëzit që pa frikë të tentojnë - pa frikë nga gabimi!

Ndërkaq, siç thekson, Karl Popper, përmes metodës “Trial and Error”, raca njerëzore ngjashëm sikur të gjithë organizmat tjerë (seleksionimi natyrorë), e gjen këndin e vetë në këtë botë. Ky metodë i tentativës dhe gabimeve çon drejt rritjes së vazhdueshme dhe përsosmërisë së diturisë, siç është, në pajtim me teorinë biologjike të evolucionit të llojeve, çdo organizëm i gjallë në mënyrë primare përballet me zgjedhjen e situatave problematike me qëllim të ekzistencës së vetë.

60. UDG, edhe pse bazohet në logjikën e lirisë, nuk pranon konceptin mikroborgjez të konkurrencës, konkurrencës të kuptuar si “lufta në jetë a vdekje”, luftës të bazuar në idenë e “shumës zero” dobia ime është humbja e dikujt! Si të thyejmë këtë logjikë ballkanike? Logjikën e cila nga të tjerët krijon vetëm armiq?... Si të zhvillohet logjika e tolerancës dhe bashkëpunimit? Si të besohet në logjikën “win-win” – se në bashkëpunim fitojnë të dyja palët? Kjo është sjellje të cilën duhet ta zhvillojmë - të gjithë bashkëpunëtorët, arsimtarët dhe studentët në UDG.

61. UDG zhvillon koncept specifik në të kuptuarit e konkurrencës. Konkurrenca nuk kuptohet si luftë me të tjerët, luftë kundër të tjerëve, që të fitohet hapësira e vetë jetësore. Konkurrenca në UDG, kuptohet në kontekstin e dëshirës – “që sot të jem më i mirë se dje, nesër më i mirë se sot” (Igor Millanoviq). Kjo praktikisht do të thotë se në UDG ka vend për të gjithë ata që kanë ide, kreativitet, iniciativa, aftësi afariste. Për të gjithë ata të cilëve UDG duhet tu shërbejë si kornizë institucionale për realizimin e ideve. Logjika e UDG është se për njerëzit kreativ nuk ekziston hapësirë e nxënë nga të tjerët!... Shumë është më mirë p.sh. që për një disiplinë të kihet pesë profesorë e jo vetëm një i vetëm! Ky është edhe shkaku që në UDG kemi numër gjithnjë e më të madh të njerëzve nga Mali i Zi të cilët kanë mbaruar studimet e magjistraturës dhe doktoratën jashtë dhe se jemi universitet me forcë tërheqëse për njerëzit e tillë. Askush nuk guxon të refuzohet nga UDG, nëse është krijuar, nëse mund “të fitoj për vete” dhe të zhvillojë veten, pavarësisht a do të ekzistojë ai vend pune apo jo në sistematizimin burokratik. Të gjithë njerëzit kreativ nga mbarë bota janë të mirëseardhur në UDG dhe të bashkëpunojnë me UDG.

62. Te studentit duhet zhvilluar ndjenjën për **vetë punësim!** Hapja e firmës së vetë! Për këto qëllime në UDG është themeluar **Qendra studentore e biznesit**, dhe ka filluar punën **inkubatori për firmat e reja...** Orientimi i studentëve drejt lëmenjve ku krijohet para, e jo në lëmenjtë në të cilat bëhet (para)shpërndarja e parave. Orientimi në lëmenjtë ku kërkohet kreativitet shpirtërorë, e jo vetëm imitim dhe dëgjueshmëri. Orientimi i studentit drejt vetes, që zgjidhjen e problemit ta pres nga vetja, e jo nga dikush tjetër -p.sh. nga shteti.

63. E-mail komunikimi është formë e rëndësishme e komunikimit në UDG. Është e nevojshme të punohet në avancimin e e-mail komunikimit e në drejtim të ngritjes së kualitetit të stilit, estetikës, drejtshkrimit, gramatikës, qartësia e përmbajtjes së çdo mesazhi përmes e-mail. Po ashtu, komunikimi në rrjetin zyrtar të UDG duhet ruajtur në kuadër, para së gjithash të komunikimit profesional. Duhet mënjanuar shkrimin pa lidhje të e-maileve, pastaj përdorimin e shprehjeve të rrugës, asociacione të pavend, e të ngjashme. Nuk duhet harruar se ajo që është shkruar (teksti, libri, e-mail) e ka **jetën e vetë të pavarur**, pavarësisht edhe nga autori dhe nga ai që i pranon ato dhe askurrë nuk dihet kush mund të vijë deri te ai - rastësisht apo me qëllim. Kjo gjithsesi mund të ndikojë në imazhin personal. Arsimitarët dhe bashkëpunëtorët do të duhej ti tërheqin vërejtjen studentit në mënyrë profesionale dhe ti japin këshilla si të avancojnë e-mail komunikimin e tyre...Paramendoni që nesër në komunikim studentit ynë i shkruan mbikëqyrësit e-mail analfabet, brutal... Kjo është fillimi i fundit të karrierës, por edhe rrezikon imazhin e UDG.(Është e nevojshme që në fillim të studimeve të mbahet kurs i shkurtër për metodologjinë dhe stilin e të shkruarit të e-mail!)

Po ashtu duhet respektuar rregullën se mesazhi i dërguar me e-mail ose informacioni në sajt, konsiderohet e pranuar 7 orë pasi që është dërguar, respektivisht publikuar... Justifikimet se “nuk e kam lexuar e-mailin “ nuk e kanë pesën e arsytimit. Natyrisht, kjo vlen për të gjithë studentët, por edhe profesorët dhe të punësuarit në UDG.

64. Kultura globale, bontoni zyrtarë dhe komunikimi zyrtarë, jeton gjithnjë e më tepër në botën globale. Studentët tonë, të cilët shkojnë në pension (nëse do të ekzistojë fare në të ardhmen) në fund të këtij shekulli dhe do të jetojnë në botën gjithnjë më të globalizuar, në një botë gjithnjë e më të dendur, në planetin në të cilin nuk do të ketë “vend për tu ulur”. Nuk do të jetojnë në botën e mjediseve të mbyllura, të vogla dhe lokale; nuk do të jetojnë secili në skenën e vetë. Do të jetojmë në bashkësinë e dendur botërore - puna në të do të kërkojë njohjen e principeve themelore të bontonit, komunikimit zyrtar dhe, mbi të gjitha, njohjen e kulturave të popujve të ndryshëm. **Njohja e kulturës së popujve tjerë**, është kusht për bashkëpunim dhe raporte zyrtare, për të jetuar me ta. A mendon ndo kush se qytetin në Llushticë (rreth 20 mijë banorë), do ta banojnë njerëzit nga Mali i Zi? Ose do të jenë të huaj? Se hyrja në UE do të thotë hyrje në “mgirimet evropiane të popullsisë”? Vallë, hyrjen në UE, a nuk mund ta kuptojmë, nga perspektiva historike, si përsëritje të “ardhjes së Sllovenëve nga pas Karpatet” ose shtyrjen e Ilirëve? A thua se mplakja e banorëve në Mal të Zi dhe rajon, a do të jetë sfidë për ardhjen e të rinjve nga vendet tjera (Turqia, Kina ...). Nëse Mali i Zi, kërkon të jetë destinacion turistik, e jemi në pritje të turistëve nga e gjithë bota, a duhet njohjen e kulturave të ndryshme dhe kulturës globale nga ana e “popullatës lokale” ta kuptojmë si parakusht për zhvillimin e turizmit? A është e mundur të zhvillojmë turizmin e lartë e popullata lokale të mos flasë 4-6 gjuhë? Gjuha, mos është komunikimi mes kulturave të ndryshme? Si të sillemi

zyrtarisht ? Si ta kuptojmë se kontrata është njëjtë sikur ligji? Se **fjala e dhënë** është bazë e raporteve të shëndosha në biznes ? Se... UDG duhet të zhvillojë mes studentëve, bashkëpunëtorëve dhe arsimtarëve frymën e tillë, globale zyrtare!

65. UDG investon në zhvillimin e shpirtit të hapur të studentit, në veçanti përmes mobilizimit të tyre. Inkurajojmë studentët të qëndrojnë në universitetet tjera dhe provimet e dhëna atje i pranojmë pa ndonjë vështirësi. Në veçanti do të vlerësohen provimet e dhëna sipas principit distance learning, respektivisht përmes kurseve në sajtin [www.course.org](http://www.course.org). Të gjitha provimet e dhëna në këtë platformë do të pranohen. Trajtim të njëjtë do të kenë edhe provimet e dhëna në shkollat elitare verore, sidomos në SHBA, Kinë, Korenë Jugore dhe në Australi.

66. UDG askurrë nuk guxon të largohet nga principi të cilin kemi promovuar në fillim se nëse kushdo që të gjejë ndonjë student të pakënaqur me atë që i është ofruar në UDG – **do të ketë të drejtë në shkollim falas ose në kthimin e mjeteve që ka paguar ...** Natyrisht, të drejtë pakënaqësie kanë vetëm ata të cilët plotësisht kanë kryer obligimet e veta nga Kontrata për studime dhe “kërkesa” e të cilëve nga UDG, është më shumë se ajo që u ofrohet.

67. Të gjithë profesorët, bashkëpunëtorët dhe studentët, e kanë obligim të marrin pjesë në debatin lidhur me këto ide nga ky material e të cilat, para së gjithash, do të organizohen në tryezat tona tradicionale të rrumbullakëta, me prezencën e studentëve ( rregullat për tryezat e rrumbullakëta janë pjesë e veçantë e këtij Almanaku).

Nëse UDG është Universitet privat i cili u takon **të gjithëve** që përmes tij dhe nga ai, shohin shansin për zhvillimin e vet profesional, afirmim, krijimtari por edhe kënaqësi personale, dhe nëse puna në Universitet nuk kuptohet si “disa orë në javë dhe pushim i gjatë veror me rroga të garantuara dhe marrëdhënie pune”, atëherë këto ide mund të Ju ndihmojnë, mes tjerash, edhe të përcaktoheni lidhur me bashkëpunimin e mëtejshëm me UDG. Secili ka të drejtë në **zgjedhje të lirë** në kuadër të rregullave apriori të njohura – **edhe punëdhënësit edhe të punësuarit.**

68. Respektimi i dres kodit – në orët nga profesorët, bashkëpunëtorët dhe studentët, është i obliguar. Dres kodi është indikacion sa i respektoni bashkëbiseduesit e vet dhe temën për të cilën jeni duke biseduar... Kjo dëshmon seriozitetin e Universitetit , por aq më tepër kujdesin e Universitetit për karrierën e studentëve tonë, të cilët në studime duhet të mësojnë , të fitojnë shprehje për rregullat që i presin në punë gjatë jetës! A mund të hyhet në gjykatë në pantallona të shkurtra apo në patlika ?... A mund të hyni në ministri në dekolte apo në minifund? Në takime zyrtare, a mund të shkohet në këpucë të hapura, në fanellë vere? A mund të hyhet në State Department pa pallto ? Ku mësojnë studentët? Në Universitet! Nga kush? Nga profesorët e vet... Natyrisht gjithë kësaj i parapri familja... Por...

69. UDG jeton me bindjen se çdo i ri ka talentin e vet të veçantë, se çdo i ri ka dëshirën për të arritur dhe se çdo njeri i ri ka ëndrrën e vet! UDG beson se çdo student, nëse e kupton esencën e këtij Almanaku dhe të punës në UDG, **mund të arrijë sukses në jetë, të jetë i lumtur gjatë jetës** . UDG, natyrisht kërkon bartësit e shpërblimit Lluça dhe nxënësit e mirë, por kërkon edhe ata që kanë përvojë nga jeta ( sporti, jeta e rëndë), fëmijët të cilët prindërit i kanë mësuar në punë, të rinj të cilët besojnë në vete, në fuqinë e vullnetit të vet; njerëz të rinj të cilët mendojnë për jetën e vet, tani dhe në të ardhmen. Kërkohen luftëtarë e jo dembelë! Kërkohen

guximtarë, e jo të përkëdhelur! Kërkohen ata që besojnë në jetë dhe sfidat e jetës!...Mendojmë se për secilin është e këndshme të jetë në këso shoqërie akademike, sepse “me kënd je - i tillë je”! Kërkojmë ata të cilët përmes zbavitjes dhe lojës mund të punojnë seriozisht, por edhe të ëndërrojnë!

70. Në studimet në UDG promovohet **suksesi dhe njerëzit e suksesshëm**, promovohet **lumturia dhe zbavitja!** Promovohen krijuesit! Promovohen inovatorët! Promovohen afaristët! Promovohet guximi në vend të frikës! Promovohen aksionet në vend të thashethemeve! Promovohen rezultate në vend të “fjalëve të thata”! Provohen njerëzit që kanë guximin, në vend të atyre që janë të përkëdhelur! Promovohet njerëzia, promovohen “shembuj burrërie dhe trimërie” (Mark Milani)... **Promovohet studenti dhe shpirti i tij.** Promovohet fara e të ardhmes të cilën e ka çdo student, bashkëpunëtor dhe profesor. Promovohet ideja e **HISTORISË SË TË ARDHMES!**

71. Me shpresën se përvoja Juaj pedagogjike dhe jetësore dhe vizioni i zhvillimit personal, ju kanë zgjuar interesimin për të lexuar këtë tekst metodologjik dhe vizionar disa herë dhe **jo në mënyrë diagonale**, të mendoni për mesazhet nga ai dhe në bazë të tij të punoni në përsosjen e mëtejme të metodës në mësim, por edhe të personalitetit dhe karakterit tuaj, me shpresën se nuk do të ketë ( ose do të ketë më pak) komente palanikë: “E dijë unë këtë”...”E njohur” ...”Konzervative” ...”Mua të më mësojë dikush”!...”A e din ai kush jam unë!”

Ju përshëndes me dëshirë që të respektoni përgjegjësitë e veta, të respektoni studentët, të respektoni kohën tuaj, të respektoni trashëgiminë tuaj dhe sa më gjatë të notojmë së bashku – **NË HISTORINË E TË ARDHMES!**

Prof. dr Veselin Vukotiq, rektor i UDG  
Kreator i idesë së Almanakut në mësim në UDG

## **PLATFORMA OPERATIVO - FILOZOFIKE E ALMANAKUT**

### **1) KËNGËT:**

- Në mundsh , R.Kipling;
- Momentet, H.G. Borhes;
- Të mendosh, W.D. Wintle

**2) Nata më e shtrenjtë se jeta, Petar II Petroviq Njegosh**

**3)  $S = z * i^2$  ( ekuacioni i profesorit)**

**4) “13 urdhërimet”**

**5) Tryezat e rrumbullakëta**

### MOMENTET\*

Sikur jetën time edhe një herë ta jetoja  
të bëj më shumë gabime do të tentoja,  
nuk do të përpiqesha aq i përsosur të jem,  
më shumë i relaksuar do të isha.  
Do të isha më budalla seç isha, vërtetë  
shumë pak gjëra do ti merrja seriozisht  
do të isha më pak purist  
Më shumë do të rrezikoj , më shumë do të udhëtoja  
më shumë muzgje do vëzhgoja, më shumë male do t'përshkoja  
do të vizitoja më shumë vende, të cilat nuk i vizitova  
do të haja mana më pak, e më shumë akullore  
do të kisha më shumë probleme reale, më pak të imagjinuara.  
Isha nga të kuptuarit dhe të frytshmit  
që ka jetuar çdo minutë të jetës së vet: kam pas  
edhe momente kënaqësie, qartë  
Por sikur mbrapa të kisha të kthyer,  
do të tentoja vetëm momente të vyera.  
Sepse, nëse nuk e dini, jetën e përbëjnë ato  
Vetëm momentet; tani mos i lësho  
Unë isha nga ata të cilët askund nuk shkuan pa  
termometër, termoforë ,  
ombrellë dhe parashutë;  
Sikur sërish të jetoja  
më i lehtë do të udhëtoja  
Sikur të mund të jetoja edhe një herë  
do të filloja këmbë zbatshur të ecë në pranverë  
e gjithnjë deri në fund të vjeshtës  
Në rrotulloje më shumë do të rrotulloja,  
më shumë muzgje do të vëzhgoja,  
me më shumë fëmijë do të lodroja,  
sikur para vetes jetën ta kem përsëri.  
Por, e shihni, 85 vjet i kam, e di  
Se po vdes.

**Horhe Luis Borhes**

\*Rëndësia e respektimit të kohës dhe respektimit të kënaqësive në jetë;  
Të jetojmë të vetëdijshëm se jeta është dhuratë nga Zoti.

### NË MUNDSH\*\*

Në mundsh ta ruash arsyen kur bota humbet fillin  
E fajin ty ta hedh – dhe vetes ti besosh,  
Por edhe dyshimet drejtë t'i gjykos.  
Në mundsh të rrish në pritje, në pritje pa u lodhur,  
A, kur të urrejnë, urrejtje mos të ushqesh  
Madje ndaj shpifjeve të rrish pa folur  
Me thjeshtësi, me to pa rënë ndesh.

Në mundsh të mendosh, por jo në shkatërrim  
Të ëndërrosh por jo rob ëndërrimesh,  
Dhe t'i trajtosh njëlloj e padallim  
Ngadhënjim e shpartallim – burim mashtrimesh.  
Në durofsh dot thëniet e tua të drejta  
Në kurthe për tradhtarët, kopukët të t'i kthejnë  
T'i shohësh të thyera gjërat më te shtrenjta  
E prapë t'i ndërtosh me vegla që nuk vlejnë.

Në mundsh fitoret që ke korrur t'i flijosh  
Si në kumorë, në një të vetme lojë,  
Të rrezikosh, të humbësh, e prapë t'ia fillosh  
Dhe humbjen kurrë t' mos e zësh në gojë  
Në durofsh dot muskul, nerv, puls e zemër  
Të të shërbejnë edhe kur gjithçka të duket e kotë,  
E të qëndrosh kur s'ke më asgjë veç vullnetit  
Që veç një fjale " QËNDRO" gjithnjë të thotë.  
Në mundsh të flasësh me maskarenj, por nderin ta ruash  
E të ecësh përkrah mbretit pa krenari që t' verbon  
Nëse armiku ose miku s'të bëjnë dot të vuash  
Dhe gjithçka e çmon, por veç sa meriton.  
Në mundsh të mbushësh dy minuta aq të rënda  
Me vepra që peshojnë-dije dhe mos ke asnjë dyshim  
Se jotja do jetë bota me çka ka brenda  
Dhe Burrë do jesh, o biri im!

**Rudyard Kipling**

\*\*Rëndësia e njerëzisë dhe rëndësia e njohjes së  
së vetes; rëndësia e sfidave në raport me ambiciet

### TË MENDOSH

Nëse mendoni se jeni humbës, keni humbur.  
Nëse mendoni se nuk guxoni, mos guxoni.  
Nëse mendoni të fitoni por mendoni se nuk mundeni,  
Gati është e sigurte se nuk do të mundeni.

Nëse mendoni se do të humbni, humbës jeni,  
Sepse në këtë botë, ta dini  
Suksesi fillon me vullnetin e njeriut  
Gjithçka është në gjendjen shpirtërore

**Walter D. Wintle**

Nëse mendoni se ju kanë fituar, fituar ju kanë  
Duhet menduar për vete më së miri, për tu ngritur sërish  
Duhet të jeni të sigurte në vete para se  
Të fitoni çfarëdo shpërblimi.

Në luftërat gjatë jetës nuk fiton gjithmonë  
njeriu më i fortë ose më i shpejtë,  
por, herët a vonë, ai që fiton  
është njeriu që mund të fitojë beson!

\*\*\*Rëndësia e gjendjes dhe forcës së mendimit tonë për të arriturat tona në jetë. Çfarë mendon- do të arrish!



## NATA MË E SHTRENJTË E JETËS\*

Hëne e verdhë rrezeartë me magji derdhet prore  
Poshtë kupës plot me yje natës së qetë pranverore,  
Rigon rreze të magjishme, disa ndjenja t' fshehta zgjon  
Dhe kufomën shikim-etur në epsh të ëmbël fantazon.  
Mbi të yjet porsi zgjoje valle brilante kanë hedhur,  
Nën të pikat tufa-tufa ndizen në ujin e mbledhur.  
Në kaçubë bilbili vetëm këndon këngën harmonike  
Miza t' zjarra si kometa t' vogla sillen edhe ikin.  
I menduar para çadrës, në qilim të larmë qëndro  
Dhe me shikim të kujdesshëm gjithë këtë mrekulli vështroj.  
Ndjenjat tani më janë zgjuar dhe mendimet kudo enden  
Ky shkëlqim hyjnor verbues më zhvilloj fuqitë e mendjen.  
E pastaj vij prapë në vete, në një gjendje jo njerëzore,  
I larguar fronit t' vet jam më pak diçka hyjnore;  
Parandiej me diç të ëmbël hapin madhështorë, Dianë,  
Shpirtin tim ma ka ujitur- ja shoh veç të kaltrin gjerdan.  
O trashëgimi ideale, ti na rrit pavdekshmërinë,  
Dhe me qiellin shpirt' i njerëzve ka të vetëm përgjegjësinë!  
Vesh e shpirtë në shpresë hollë me kujdes duke notuar  
Në livadhin ku lëvizin-te' ta vijnë duke shpejtuar!  
Kur shpërthen sythi i lules dhe nga trangu vesa pikë  
Gjithë' kjo veshit m' i gjëmon, tek unë është gjëmë e frikë ;  
Sa po zogu i shkundë krahët përmbi plisin plotë me barë  
Dridhjet e parajsës m' vijnë, vringëllimat veshët çajnë.  
Çdo çast është për mua orë-koha ime tash nuk shkon  
Fuqitë i kam nën kujdes, syri ikë nga do, shikon.  
Ja tek është Zanë e bukur, m' fluturon me hapë të lehtë.  
Lakmoni, gjithë' të pavdekshmit, në këtë moment të shenjtë!  
Ecja e Zanës shumë më e bukur se Aurora kur kjo sillet  
Nga prag i argjenditë i saj mbi pranverën kur po hidhet.  
Pamja e Zanës së re është plot hir si Athinaja  
Pasqyrë dhe tualet përbuzin tiparet e saja.  
Ndale hënë karron e bardhë, m'i zgjatë orët që i dua,  
Se dhe diellin mbi Inop Zanat e kanë ndaluar.  
Bukuroshen sa e shohë, si thotë Zoti e përqafoj  
E shtije përbrenda çadrës, dëshirën e shenjt plotësoj.  
Nën rreze të hënës s' ndritshme, pranë qiriut duke ndritur  
U bashkuan në flakë shpirti drejt kah shpirti i zhuritur.  
Puthjet hyjnore të shpirtit në shpirtin e dashur derdhen  
Ah, puthjet, veti hyjnore, gjithë' magjitë e parajsës erdhën!  
balsamin e shtrenjtë shërues, bashkë me aromën të gjithë  
që tokës ia fali qielli, në buzë u ula t'ia thith.  
Një krijesë e përkryer, e fuqisë hyjnore lojë  
Gjë më t' bukur asnjëherë se ajo nuk mund t' krijojë!

Të vogla buzët e ëmbla edhe faqëzat engjëllore  
nga një mijë ndjenja që kam, një nuk dijë ta nxjerrë  
prej goje!  
Porsi borë gjoksi rrethorë, tunden shenjtë e flakërojnë  
dy mollëza të fildishta në to dy lugje më tërbojnë;  
Floku i zi valë-valë nga parajsa luan me gjinj.  
O magji! Çudi e vdekjes si s'kalova në çmenduri!  
Gjoksi i hedhur më krenarë rri poshtë flokëve valore  
sesa bjeshka shumë e lartë poshtë borës shekullore.  
Kur ngrihet dielli në lindje nga fusha me lule shohë  
nëpër rrjetën mjegull hollë, madhështinë kur ja njohë.  
Unë luaj e luaj me mollët-sa dy botë vlerë kanë pasur  
si kënaqësi e pamort e privimit të fatit të dashur;  
djersa rrjedhë në flokë të saj me magji kur kokën tund...  
shpresa të tjera e gjithë' festat, do ia jepja gjer në fund.  
Tërë natën vetëm puthje-buzët nga buzët s'u ndanë  
edhe i ngopur nuk u  
n' dashuri me të bardhën Zanë.  
Lidhur janë të dy shikimet me magji të ëmbël kapur  
Posi dielli n' pasqyrim kur fluturon mbi dete të hapur.  
Hëna ikën nga horizonti dhe i lëshon Febit sundimin  
bukuroshen time t' re, atëherë humba nga shikimi!

**Petar II Petroviq Njegosh**

(marrë nga libri "Antologji e poezisë malazeze")

---

\*Rëndësia e imagjinatës, emocioneve dhe pasionit në mësim dhe në jetë... Mendimet e Njegoshit-rrënja historike e UDG!

**SI TË KONVERTOHET DITURIA NË AFTËSI  
(QASJE HOLISTIKE JETËS SË STUDENTIT NË UDG)  
“EKUACIONI I PROFESORIT” :**

<b>Aftësia e studentit të UDG</b>	<b>=</b>	<b>Dituria e studentit në UDG ( të mësuarit nga përvoja e huaj)</b>	<b>*</b>	<b>Intensiteti i jetës së studentit (gjurmimi i drejtë përvojës personale dhe të të mësuarit nga jeta)</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>* të zgjidhet problemi</li> <li>* dhembshuria (për të tjerët)</li> <li>* aksioni</li> <li>* besimi në vete</li> <li>* fisnikëria e shpirtit</li> <li>* idetë</li> <li>* vizioni</li> <li>* ambiciet</li> <li>* nevoja</li> <li>* energjia</li> <li>* jeta si lojë</li> <li>* krijimtaria</li> <li>* ndjenja e së ardhmes</li> <li>* individi</li> <li>* karakteri</li> <li>* personaliteti</li> <li>* intelekti</li> <li>* rreziku</li> <li>* mendimi kritik</li> <li>* kultura</li> <li>* fryma garuese</li> <li>* njohja e shanseve</li> <li>* jo lufta për pozicione</li> </ul>	<b>=</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>* të mësuarit asocijativ (jo vetëm reprodutiv)</li> <li>* emocionet (kultivimi i diturive)</li> <li>* fletorja si metodë e kultivimit të dijes</li> <li>* profesorët (Mali, Zi, rajoni, bota) dituria dhe karakteri i tyre</li> <li>* ekspertë nga praktika</li> <li>* libra nga universitete prestigjiozë dhe autorë botëror</li> <li>* revista vendase dhe nga jashtë</li> <li>* rrjeti i ekspertëve ndërkombëtarë</li> <li>* ndërdisiplinore</li> <li>* ndërveprim</li> <li>* profesionalizmi</li> <li>* mësimi në gjuhën angleze</li> <li>* praktike (jetësimi) i mësimt</li> <li>* prezenca e obliguar në mësim</li> <li>* mënjanimi gradual i librit –afirmimi i hrestomatisë</li> <li>* rrjetëzimi i njohurive nga lëmi të ndryshme</li> <li>* rëndësia e zhvillimit të shkathtësive të studentëve për të parashtruar pyetje, por që edhe vet të kërkojnë përgjigje</li> <li>* rëndësia e kthimit të studentit drejtë gjurmimit për (jo) diturinë</li> <li>* rëndësia e thënies së Sokratit “ e dijë që nuk dijë”</li> </ul>	<b>X</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>*atmosfera pozitive universitare</li> <li>* vullneti për sukses</li> <li>* përkushtimi ( të jetohet me) studimeve</li> <li>* kushtet e punës, organizimi i punës dhe niveli teknologjik i mësimt</li> <li>* aksione në UDG (tribuna, debate, ekspozita, mbrëmje letrare , koncerte...)</li> <li>* aktivitete sportive ( Olimpiada e UDG) * prezantimet e studentëve *“Idetë dhe karakteri”- principi i vetë arsimimit dhe vetë kreacionit</li> <li>*afarizmi dhe zhvillimi i aftësive afariste</li> <li>* biznesi dhe afarizmi kreativ</li> <li>* dres kodi dhe biznes kodi</li> <li>* kultura e të hulumtuarit</li> <li>* arsimimi (letërsia dhe poezia)</li> <li>*arti</li> <li>* gjuhët e huaja (4-6)</li> <li>* fitimet gjatë studimeve</li> <li>*organizatat dhe forumet studentore</li> <li>*bashkëpunimi ndërkombëtarë</li> <li>*shkolla verore(Tivar, Cetinë)</li> <li>*shkolla dimërore e afarizmit dhe inovacioneve</li> <li>*qendra studentore e biznesit</li> <li>*folklori</li> <li>*debatet, oratoria</li> <li>*jeta në bibliotekë</li> <li>* ushtrimorja</li> <li>* pllakate edukativ në mure</li> <li>* mësimi i obliguar dhe pjesëmarrja në aksionet e UDG</li> <li>* gara e Llovqenit në vrapim</li> <li>* olimpiada- gara sportive të studentëve në UDG</li> <li>* vendosja e bashkëpunimit me prindërit e studentëve në UDG</li> <li>* mënyra e organizimit të mbrojtjes së diplomave dhe punimeve të magjistraturës në UDG</li> <li>* Dita e UDG (11.11),dorëzimi solemn i diplomave</li> <li>* kontakti me prindër</li> <li>* përgatitje për punësim</li> <li>* dita e hulumtuesve të UDG</li> <li>* Bursa e ideve afariste</li> <li>* konferencat shkencore</li> <li>* Alumni-klubi</li> <li>* mësimi në gjuhën angleze</li> <li>* lidhjet me kompanitë</li> <li>* interneti</li> <li>* aftësitë komunikative</li> </ul>

Si të zhvillohen aftësitë e studentit; si të konvertohet dituria në aftësi? (Përgjigjja: gjurmimi drejtë përvojës).  
Ajshtajni  $E= m \cdot c^2$  - si të konvertohet masa në energji? (Përgjigjja: shpejtësia)



## **Rregullat e dhënies së provimeve në të gjitha fakultetet në UDG “ 13 urdhërimet për dhënien e provimeve dhe kologjumeve “**

1. Para se të hyjnë në studimore studentët ftohën për emër dhe hyjnë pasi që të jenë të ftuar.
2. Studenti nuk mund të fus asgjë në studimore. Të gjitha gjërat (librat, çantat, celularët, kompjuterët e të ngjashme ) duhet të jenë jashtë studimores.
3. Palltot, xhaketat dhe të gjitha sendet e ngjashme të veshjes, duhet varur në vendin e caktuar dhe nuk guxojnë të jenë në banka. Nëse ndonjë send i ngjashëm gjendet gjatë provimit në bankë- studentit largohet nga provimi dhe merr notën pesë, duke humbur të drejtën e hyrjes në provim edhe në afatin e ardhshëm.
4. Studentët radhitën në atë mënyrë që ka vendosur udhëheqësi i provimit. Studenti është i obliguar të shikojë vendin ( tavolinën, dyshemenë ) rreth ulësës së vet dhe ta pastroj atë nga letrat eventuale dhe çfarë do që është e ndaluar të futet në sallë. Pas kësaj çfarë do që eventualisht të gjendet në afërsi të studentit - do të trajtohet si e tij dhe studentit përjashtohet nga provimi duke iu nënshtruar dënimit disiplinorë.
5. Studenti fiton letrën e vulosur të nevojshme për të shkruar përgjigjet dhe studentit është i obliguar që të kthejë të gjitha letrat e marra dhe letrën me pyetjet e provimit. Nëse studentit nuk i kthen të gjitha letrat – materiali i shkruar nuk do të shikohet dhe studentit automatikisht dënohet që të hyj në atë provim në afatin e ardhshëm.
6. Studenti fiton letrën me pyetjet e provimit. Ai në pyetje përgjigjet me radhë siç janë dhënë në fletën e provimit ( në test ) dhe në rast se nuk respektohet radhitja e pyetjeve, fleta nuk do të shikohet dhe nuk do të vlerësohet.
7. Në rast se studentit sjellët anash, pëshpërit ose shfrytëzon ndonjërin nga mjetet e ndaluara për të futur në sallë ( duke kyçur këtu edhe telefonin celular në xhepin e studentit ) automatikisht largohet nga provimi. Po ashtu studentit do të largohet nga provimi nëse në afërsinë rreth tij gjendet ndonjë letër, fletore dhe të ngjashme. Për këto veprime nuk është e nevojshme të vërtetohen – mjafton dyshimi arsimtarit apo bashkëpunëtorit.
8. Pasi që të ketë marrë pyetjet studentit ka në dispozicion pesë minuta për ti lexuar ato dhe për sqarimin eventuale të pyetjeve nga ana e profesorit apo bashkëpunëtorit. Pyetja e studentit lidhur me përgjigjen profesorit ose bashkëpunëtorit i bëhet publikisht që të gjithë studentët të dëgjojnë pyetjen dhe përgjigjen. Pas kësaj është rreptësisht e ndaluar të parashtrihen pyetje dhe të kërkohen sqarime shtesë si dhe çfarë do komunikimi i bashkëpunëtorit me studentin gjatë provimit.
9. Bashkëpunëtorit, respektivisht arsimtarit i cili nuk respekton këto rregulla për mënyrën e dhënies së provimit me shkrim i nënshtrohet komisionit disiplinorë me mundësi të përjashtimit nga UDG.
10. Çfarë do shkeljeje e këtyre rregullave ka për pasojë dënimin disiplinorë më së paku humbjen e të drejtës për të hyrë në provimin ose kologjumin e radhës nga ajo lëndë, e deri te mundësia e përjashtimit nga UDG, për ç' gjë vendos komisioni disiplinorë i universitetit. Dënimi shpallet publikisht në sajtin e fakultetit dhe universitetit.
11. Secili provim ka kohë zgjatjen e vetë dhe secili bashkëpunëtor, respektivisht profesor, është i obliguar që në fillim të provimit të shkruajë qartë kohën deri kur zgjatë provimi. Pas këtij afati punimet nuk mund të pranohen. Bashkëpunëtori, respektivisht arsimtari, nuk ka të drejtë në vendim diskret në ndryshimin shtesë të afatit për përfundimin e provimit me shkrim.
12. Gjatë provimit nuk lejohet hyrja e askujt, përveç personave të cilët atë ditë janë të obliguar për provim, menaxherit të fakultetit, dekanit, prodekanit ose rektorit.
13. Rreptësisht është e ndaluar që bashkëpunëtorët të fusin me vete telefonat celularë. Studentit është i obliguar për ti tërhequr vërejtjen bashkëpunëtorit ose arsimtarit i cili shfrytëzon telefonin celularë, ose më vonë ta paraqes te dekani i fakultetit. Po ashtu, bashkëpunëtori dhe arsimtari nuk mund të shfrytëzojë kompjuterin gjatë provimit.

---

\*Rëndësia e respektimit të rregullave, apriori të definuara, për edukimin e studentëve, bashkëpunëtorëve dhe arsimtarëve.

---

**Tryezat e rrumbullakëta:  
UDG NË TREGUN GLOBAL\*  
-principet e organizimit**

Qëllimi: Operacionalizimi i ideve të Almanak dhe marrja e obligimeve personale dhe përgjegjësi nga ana e arsimtarëve, bashkëpunëtorëve dhe studentëve.

- Fjala hyrëse dhe drejtimi i tryezës së rrumbullakët: prf.dr Veselin Vukotiq, kreator dhe bartës i idesë
- Panelistët:
  - Katër panelistë të cilët janë paraqitur të parët në diskutim në këtë Tryezë të rrumbullakët nga radhët e profesorëve dhe bashkëpunëtorëve;
  - Një panelistë nga radhët e studentëve të studimeve të magjistraturës dhe doktoraturës;
  - Dy panelistë nga radhët e studentëve të studimeve themelore;Panelistët kanë mundësinë të shprehin mendimet e veta në kohën prej 7 minutësh.
- Diskutuesit nga publiku (deri në pesë diskutues)- kush paraqitet me kohë – deri në 4 minutë;
- Principi i zgjedhjes së panelistëve dhe diskutuesve: “Kush i pari vajzës, e tij është vajza”.
- Pyetjet dhe komentet nga publiku- kush paraqitet i pari në Tryezën e rrumbullakët- deri në 2 minutë;
- Debati do të inçizohet;
- Kohëzgjatja e tryezës së rrumbullakët- deri në 111 minuta;
- Sekretari zyrtarë-administrativë i Tryezave të rrumbullakëta: Marija Radunoviq, studente e UDG ;
- Paraqitja në diskutim në e-mail : [os@udg.edu.me](mailto:os@udg.edu.me) ;

**TEMAT E TRYEZAVE TË RRUMBULLAKËTA \*\*  
-Viti akademik 2013/2014-**

- I)  $S=z \cdot i^2$  (“EKUACIONI I PROFESORIT”), Mars, viti 2014 (paraqitja prej 1-5 dhjetorë 2013 vj.);
- II) SI DERI TE VETË PUNËSIMI?, Prill 2014 (paraqitja prej 1-5 Mars 2014);
- III) SI TË VENDOSËN LIDHJET ME SHKOLLAT E MESME NË KONTEKSTIN E IDEVE DHE PRINCIPËVE TË ALMANAKUT?, Maj 2014-me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shkollave të mesme (organizimi dhe rregulla të veçanta);

- 
- Rëndësia e shqyrtimit dhe përvetësimit personal në avancimin e më tejme të ideve të Almanakut.
  - Të gjitha debatet do të inçizohen dhe do të publikohen si dëshmi e të menduarit në një kohë.

## **GEJZER PLATFORMA-HISTORIA E TË ARDHMES**

**(Si të shmangim robërimin e mendimit personal dhe emocioneve të veta në mënyrë të njohur dhe të pranuar përgjithësisht? Si të shndërrohet e tashmja në histori ? )**

- 1) PLANI MËSIMORË "FUTURIST"- shikimi nga e ardhmja në ne sot**
- 2) ARSIMIMI DHE (PA)BARAZIA- iluzionet e sotme**
- 3) "KUSH EDUKON EDUKATORËT ? "-a e marrim këtë parasysh sot?**
- 4) FUNDI I POLITIKËS SË SOTME- A mund të paramendojmë fundin e partokratisë ?**

---

**GEJZER PLATFORMA- idetë nga intuita e zemrës-**  
**-Si të shikojmë në problemet e sotme në zhvillimin e arsimit nga e ardhmja ?-**

**I) PLANI ARSIMORË FUTURIST-Viti 2030**

Si do të dukeshin studimet në UDG të organizuara sipas këtij plan programi dhe sipas emërimit të sotëm të disiplinave, me profesorë-mentor nëpër botën mbarë(fizikisht nuk janë në UDG), në vitin 2030?

Ideja e këtij plani vizionarë është integrimi i diturisë, mënjanimi i feudalizimit të tashëm të shkencës. Nëse bota është duke u globalizuar, a është e mundur që shkenca të mbetet kështu e shpërndarë? A do ta zhvillojmë më tej “zombi” logjikën ose të kthehemi p.sh. te Aristoteli, më tepër te Talesi, filozofi i parë i llojit njerëzorë ? A e dimë se sipas kriterëve të sotme nuk do të mund të përcaktonim profesionin e Aristotelit- është marrë me shumë disiplina të ndryshme. Çfarë mendoni, a do të mund të zgjidhej Aristoteli si profesorë i universitetit të sotëm ? Ose Nikolla Teslla ?... Ose... Vallë a nuk është kjo periudhë e të mësuarit formal ? Mirëpo, gjithnjë e më tepër kërkohet **aftësia** në vend të **mësuarit formal**.

---

<b>Viti I ( dy semester )</b>	<b>Viti II (dy semester)</b>
1.Shpërthimi i madh dhe shpikjet e evolucionit; 2.Robinson Kruso-njeriu në natyrë; 3.Popullsia-shpërnguljet e mëdha; 4.Historia e ideve(kulturave) dhe civilizimeve; 5.Mitologjia dhe religjioni; 6.Filozofia dhe metafizika; 7.Arta dhe historia e artit; 8.Letërisia dhe zhvillimi; 9.Gjuhët e huaja dhe kulturat; 10.Zanati dhe lidhja me jetën; 11.Sporti dhe loja. (lëndët e përbashkëta për të gjithë studentët)	1. Matematika dhe historia e ideve matematikore; 2.Fizika,kimia dhe historia e ideve të natyrës; 3.Biologjia dhe sekretet e jetës së njeriut; 4.Antropologjia dhe arkeologjia; 5.Filozofia e poezisë; 6.Filozofia e kohës(klima, meteorologjia); 7.Filozofia e moralit dhe etikës; 8.Gjuhët e huaja dhe kulturat; 9.Zanati dhe lidhja me jetën e individit; 10.Sporti dhe loja; (lëndët e përbashkëta për të gjithë studentët)
<b>VITI III</b>	<b>VITI IV</b>
1.Kosmologjia dhe përvetësimi i gjithësisë; 2.Zanati-përvoja jetësore e individit; 3.Gjuhët e huaja dhe kulturat; 4.Filozofia e energjisë dhe teknologjisë; 5.Filozofia dhe historia e idesë së profesionit (p.sh. ekonomisë, drejtësisë, arkeologjisë,...); 6-10.Rruga drejt profesionit (ndarja e studentëve nëpër studime-fakultete);	1.Zanati-përvoja jetësore e individit; 2.Gjuhët e huaja dhe kulturat; 3.Sporti dhe loja; 4.Psiko-filozofia e shoqërisë globale; 5.Filozofia dhe historia e idesë së profesionit; (të arriturat e profesionit); 6-10.Rruga drejt profesionit (ndarja e studentëve nëpër studime-fakultete);

---

E si do të ju dukej kur e gjithë kjo të mos organizohej fizikisht në shkollë ose në UDG, por studentët tonë të ishin nëpër botë? Distance learning...duket çmenduri? Vallë këtë nuk e propozon “njeriu i çmendur”? dhe shumë pyetje tjera.. A thua e ardhmja i takon **homo oeconomicus, homo politicos**, ose ndoshta **homo ludens**?... e të gjithë flasin për ndryshimin e paradigmës, respektivisht civilizimit ...

A e kuptojmë Almanakun si rrugë drejtë arsimit të këtillë futurist apo me kokëfortësi thellohem në përvojën tonë, të kaluarën, në bindjen se arsimit është konservativ dhe nuk duron ndryshime?

Qëllimi i gejer platformës është pikërisht të na përjashtojë nga të heshturit dhe pozicioni i tashëm inert!

A është propozim Plani i mirë?

Kjo është e pa rëndësishme! Me rëndësi është që të gjithë të hetojmë **trendin e ndryshimeve. Se duhet të ndryshojmë!** Në cilin drejtim? Si ? Kjo është liria e zgjedhjes e çdo individit! Largimi nga pritjet se ministria e arsimit me rregullat e veta do të përcaktojë çka të punojmë dhe çfarë tu ligjërojmë studentëve. Mësimi ka ekzistuar edhe para Ministrisë së arsimit... e do të ekzistojë edhe pas saj! Në vend të logjikës së institucioneve të përkohshme – provoni të kuptoni logjikën e natyrës dhe të shpirtit të natyrshëm në neve!

## II) ARSIMI DHE ( JO ) BARAZIA <sup>1</sup>

A do të zhduket sistemi i tashëm i arsimit? A do të zhduken shkolla dhe universiteti në mënyrën se si janë sot të organizuara? Sipas shumë futuristëve fillimi i fundit të kohës së arsimit ( “ shkollës” ) veç ka arritur. Para kësaj, theksohet gabimisht se arsimit ( përmes sistemit shkollor ) është i vjetër sa edhe bota. Fakti është se ajo plotësisht ka filluar me kapitalizmin. Arsimitimi i fëmijëve për herë të parë përmendet në Francë në 1498 ( tri vite pas hapjes së shtypshkronjës Obod ). Mirëpo, njerëzit kanë mësuar edhe para “ lëvizjes së arsimit “, e edhe sot mësojnë jashtë lëvizjes së arsimit. Lëvizja e arsimit në shekullin e tetëmbëdhjetë ka përhapur bindjen se njeriu ka lindur budalla ( “ tabula rasë” ) dhe se nuk posedon aftësitë themelore për jetë, përveç nëse arsimohet...e si ka mbijetuar njeriu 200.000 mijë vite pa “ lëvizjen e arsimit” ? Në ç’ mënyrë kjo qenie e marrë njerëzore ka arritur nivel aq të kartë “ të mençurisë dhe inteligjencës” në kohën e paraqitjes së shkencës dhe teknologjisë ? A ekziston ndonjë farë sqarimi historik në ç’ mënyrë “ njeriu budalla” ka ardhur në idenë aq të mençur e cila quhet arsimit? Arsimit ( “ shkolla dhe institucionet shtetërore të cilat e mbrojnë atë “ ) gjithkund dhe gjithmonë promovohet në emër të barazisë dhe drejtësisë. A nuk është e kundërta? Vallë, ata të shkolluarit më mirë nuk janë klasa e re në shoqëri – klasa e re e fisnikëve? A mos nxit arsimit dallimet sociale dhe klasore? Përse janë në parlament p.sh. Në Mal të Zi vetëm “ njerëz të shkolluar” ( kanë kaluar trajnimin arsimor përmes institucioneve për mbrojtjen e sistemit shtetëror burokratik ) – si janë të gjithë “ përfaqësuesit e popullit” vetëm nga grupi i të shkolluarve me mësim të lartë, e të cilët përbëjnë gjithsej 12% të popullsisë malazeze?

---

<sup>1</sup>Rëndësia e braktisjes së iluzionit se arsimimi shkollorë çon drejt barazisë në shoqëri dhe kuptimi i rëndësisë së arsimit “Jashtë shkollës” në të ardhmen e afërt.

Çfarë është me 88 % të qytetarëve të malit të Zi të cilët “ nuk kanë mbaruar shkolla” dhe nuk janë në parlament, e në kontekstin e përhapjes së iluzionit për barazi dhe demokraci? A nuk do të ishte më e drejtë që përfaqësuesit e popullit të zgjedhën me **short**, e jo në **zgjedhje**? A nuk do të vinte atëherë në shprehje më tepër struktura reale e popullsisë? Personat me fakultet të kryer do të ishin gjithsej 1/8 nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Parlamentit ( 12% me pjesëmarrje në popullsi). A nuk konsiderojmë të gjithë se kjo është “ marrëzi” ? A nuk jeni ju të gjithë kundër elitizmit, sepse ai rrënon demokracinë? A mund të paramendojmë të përshkruarën në paradigmen e tanishme? Jo! Por, paradigmat ndryshojnë! Si? Lexoni veprën e Kuno “ struktura e revolucioneve shkencore”...populli thotë “ Çdo gjë që shkon, vjen shpejt”.

Nga këndvështrimi i fuqisë së njerëzve në sistemin e tanishëm të arsimit a mos është faktor kyç **mos barazia**? Shteti i sotëm, si institucion, a mos është gjithnjë e më tepër instrument për ruajtjen e fuqisë dhe privilegjeve të atyre me shkollim të lartë? Elita e tanishme me shkollim të lartë, të cilës i takoj edhe unë, nuk ka shfrytëzuar pa pagesë paratë e huaja ( tatimet ) gjatë 20-25 viteve për shkollimin e vet ( nga shkolla fillore deri në post doktoratë )? A është kjo, e ashtu quajtura **drejtësi sociale**? Përse shkollimin tim ta paguajnë ata të cilët janë në fundin e tabelës shoqërore të fuqisë dhe ndikimit? Përse taksisti, punëtori i komunales, bujku, të paguajnë shkollimin e të ashtu quajturës të **fuqisë elitë**?... Natyrisht, kjo quhet kujdesi i shtetit për arsim!

Edhe sot, në kuadër të sistemit të tanishëm, a mos ekziston **diskriminimi** ? Favorizohet gjithçka që është shtetërore – në mënyrë që logjika e shtrirjes së tanishme të shtetit ( në veçanti në Evropë )të mbrohet me gjeneratat e reja “ të drejtësisë sociale “, “ luftëtarëve për barazi “...Në konceptin e tanishëm të “ demokracisë “ politike dhe organizimit të shtetit vlen parimi se “ **të gjithë jemi të barabartë e disa janë më të barabartë se të tjerët**”.

A thua arsimimi shkollor përmes institucioneve të shtetit ( tani edhe private ) është vërtet mënyra e vetme e përgatitjes për jetë? A është kjo mënyra e vetme për të arritur diturinë? A duhet edhe gjeneratave të reja tu ofrohet edhe më tepër sistemi i tanishëm se **të mësosh për botën** është shumë më mirë se **të mësosh nga bota** ( jeta )? Si të lirohemi nga prangat e sistemit të tanishëm të arsimit?...**Vetëm nëse kuptojmë ekzistimin e këtyre prangave, mund të avancojmë mësimin në UDG, mund të respektojmë idetë e Almanakut në mësim.**

### III) “ KUSH I EDUKON EDUKATORËT ? ”<sup>2</sup>

A mjafton që edukatorët të jenë ata me notat më të mira në diplomë, në veçanti në shkollimin e lartë? A është publikuar artikulli ( të cilin pak kush e lexon ) në revistat prestigjioze garanci për zgjedhjen e mirë të edukatorëve ( profesorëve dhe bashkë punëtorëve )? A është numri i citimeve të ndonjë autori dëshmi e diturisë dhe njohurive shkencore të tij, aq më parë nëse e dimë se ekziston edhe “ shkëmbimi i citimeve miqësore “, dhe se kryesisht citohen punimet të cilat nuk janë lexuar ( “ **efekti i snobizmit** “ ), e nuk citohen punimet që ishin bazë për punimin e autorit ( “ efekti i përbuzjes së të njohurit” )?

---

<sup>2</sup>Rëndësia e mënjanimit të iluzionit se çdo kush mund të jetë arsimtarë nëse ka “nota të mira” gjatë shkollimit; Përhapja e bindjes se arsimtarët janë edukator shpirtëror të nxënësve dhe studentëve.



A do të mund të zgjidhej sot p.sh. Aristoteli në ndonjë universitet? Nikolla Tesla? A do të mund të ligjëronte letërsinë Njegoshi? Ose, krajl Nikolla, politikologjinë? A do të mund të ligjëronte filozofinë liberale, Sula Radov? Ose Mark Milani? Si kështu të gjithë citojmë këta njerëz, të gjithë mësojmë nga ata, e ata nuk do të mund të kyçeshin zyrtarisht në sistemin tonë të tanishëm të shkollimit? Përse në sistemin e tanishëm shkollor e kyçim shpirtin e këtyre njerëzve por fizikisht ( sikur të ishin gjallë ) nuk do të mund “ ti zgjedhim dhe emërojmë “? Vallë, a mos është shpirti jashtë kohës? Nëse është kështu, përse shpirti nuk është kriter për zgjedhjen ( nëse kjo është e nevojshme ) e ndonjërit për profesorë, e jo kriteret materialo – mekanike dhe burokratike?

A jemi duke kuptuar se kultura ( shpirti ) dhe civilizimi ( teknologjia, mjetet ) nuk janë të njëjta? Civilizimet zhduken, kulturat jetojnë! Ka humbur mbretëria romake, por shpirti i drejtësisë romake jo – edhe më tej ndjehet në studimoret e fakulteteve juridike.

Si të jetë edukimi **më tepët nga kultura** ( shpirti, sistemi i vlerave, mënyra e të menduarit, traditës, zakoneve, historia e ideve, folklori, sporti, mitologjia, religjioni...), e më pak **nga civilizimi i orientuar për shfrytëzim**, qasjes mekanike të realitetit, mendimit të mykosur- burokratik dhe të rregulluar, civilizimit e cila ka shtypur shpirtin, ndjenjat, emocionet, meq donallds civilizimit?

Nuk duhet pritur **kërcime kuantike** të kalimit nga civilizimi i tanishëm ( homo economicus dhe homo politicos ) në civilizimin e kulturës ( të ideve dhe lojës ) – homo ludens.

Historia na mëson ( “ Historia është mësuësja e jetës “ ) se këto kalime janë të gjata, me gjenerata...por, popujt dhe individët të cilët ishin në frekuencat të cilat i ka emetuar e ardhmja gjithmonë kanë arritur më tepër se ata të cilët kanë besuar, se të bllokuar nga zgjidhjet e njohura, është rruga drejtë lumturisë dhe përparimit.

Shumë është më e lehtë të pranohet pa kritik dhe në mënyrë dogmatike përjetshmëria e modeleve të tanishme se sa të dyshohet në të dhe të besohet në ndryshueshmërinë e tyre historike. “ Por unë atëherë nuk do të jem i gjallë!”... Por, a do të jetë i gjallë shpirti yt: Kjo është ajo që kërkohet nga edukatori – të tentojë ta mbijetojë shpirti.

Respektimi i principeve të Almanakut është pikërisht puna në shpirtin personal!

#### IV) FUNDI I POLITIKËS SË TANISHME<sup>3</sup>

A është e mundur të paramendohet se politika, e kuptuar në kontekstin e perceptimit të saj të tanishëm – vendimmarrja për paratë e huaja të marra me forcë ( shpërndarja përmes institucioneve të pushteti) është afër përfundimit?

A është, së paku civilizimi Perëndimorë, i sëmurë nga kanceri i cili quhet **deficit buxhetor**? A mund të ekzistojnë institucionet dhe civilizimi ( shteti nacional ) i bazuar në to nëse shpenzon më shumë se ç’ është forca ekonomike e atyre që i mbajnë?

---

<sup>3</sup>Mënjanimi i iluzioneve se modeli i tanishëm i politikës ( demokracia partiake) është i përjetshëm; të kuptohet se Dielli është më i madhi gjatë perëndimit!

Modeli i tanishëm i demokracisë - demokracisë partiake – a e zmadhon numrin e të punësuarve në shtet dhe kvazi-shtet – çdo parti që hyn në pushtet bën punësimin shtesë të ithtarëve të vet, duke mos larguar të punësuarit më parë, në administratë?

Sjellja kah protekcionizmi gjithnjë e më e madhe dhe rregullimi zmadhon kërkesën, të ashtu quajturën kapaciteti administrativ i shtetit, që do të thotë numër më të madh të punësuarve.

Ndikimi i faktorit demografik në mënyrë afat gjate është shumë i fuqishëm. **Rritet jetëgjatësia e mesme** që zmadhon numrin e të moshuarve të popullatës dhe njëkohësisht **zvogëlimin e natalitetit** – është zvogëluar numri i të rinjve, struktura e të moshuarve të popullsisë nga forma e kapelxhive kalon në formën e këpurdhave. Pa të rinjtë nuk ka taksa të reja për mirëmbajtjen e pleqve...pa të rinjtë nuk ka biznese të reja!

Çfarë do të jetë dhe si do të jetë politika në shtet e cila zhvillohet në hijen gjithnjë e më të madhe të këpurdhës?

#### **V) SI DERI TE TË KUPTUARIT E MODELIT TË UDG?<sup>4</sup>**

Ndoshta historia na mëson: **Edhe shtypshkronja Obod** ka qenë në rrugën, nga lindja në Cetinë, kurse **Njegushi**, në rrugën nga Perëndimi drejt Cetinës...Si të jeni sot në rrugën nga drejtimi i mitit të ri planetar – miti i globalizimit? Orientimi nuk është i lehtë-rrymat dhe erërat e globalizimit vijnë nga të gjitha drejtimet. Pasiguria bëhet pjesë përbërëse e jetës...mirëpo, disa shenja për orientim drejtë të ardhmes ekzistojnë...Almanaku i mësimi identifikon disa prej tyre...Secili nga UDG duhet ti njohë gjithnjë e më tepër!

#### **VI) SI E PARAMENDONI PREZENCËN E VETË NË SHËNIMIN E DITËS SË UDG DHE NDARJEN E DIPLOMAVE MË 11.11.2111?**

Këtë pjesë të Almanakut e shkruan secili për vete!

\*\*\*

---

<sup>4</sup>Duhet mënjanuar paragjykimet se UDG është universitet në main-stream studime; Të zhvillohet bindja se UDG është universitet në vijën e historisë së ardhmërisë!

